



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 13 DHJETOR 2018, TIRANË

PROCESVERBAL

SEANCËN E DREJTON
KRYETARI I KUVENDIT
GRAMOZ RUÇI

(Seanca filloi në orën 10:00)

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të datave 22.11.2018 dhe 03.12.2018 *(neni 44 i Rregullores)*

2. Njoftimi i projektligjeve të depozituara në Kuvend *(neni 44, pika 3, i Rregullores)*

3. Projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr.7764, datë 02.11.1993 “Për investimet e huaja”, i ndryshuar” *(nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)

4. Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" *(nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)

5. Projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr.93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar” *(nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)

6. Projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr.55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë” *(nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)

7. Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar” *(nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Integrimin Europian.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)

8. Projektligji “Për një shtesë në ligjin nr.9374, datë 21.04.2005 “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar” *(nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)

9. Projektligji “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore” *(vazhdon*

shqyrtimi në komisionin përgjegjës) *(nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Sigurinë Kombëtare.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)

10. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar” – nismë deputeti *(nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)

11. Projektvendimi “Për emërimin e një anëtarit të Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë” *(neni 111 i Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Shprehet Komisioni përgjegjës për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit

12. Të bartura për votim:

- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” *(neni 81/2 i Kushtetutës dhe nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë prej 3/5-ve të të gjithë anëtarëve të Kuvendit)*

- Projektligji “Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar” *(neni 81/2 i Kushtetutës dhe nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë prej 3/5-ve të të gjithë anëtarëve të Kuvendit)*

13. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës *(neni 45 i Rregullores)*

Koha e diskutimeve deri në 60 minuta

Gramoz Ruçi – Mirëdita!

Seancën plenare të ditës së sotme e deklaroj të hapur!

Sot në rendin e ditës kemi për të miratuar këto çështje:

(Lexon rendin e ditës.)

Ju bëj me dije se projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9355 datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" e kanë shqyrtuar komisionet parlamentare, por është dakordësuar me nismëtarin, deputetin Sinaj, si dhe me Këshillin e Ministrave për një projektligj të ri "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i cili pritet të depozitohet së shpejti në Kuvend.

Në lidhje me projektligjin "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore", ju bëj me dije se po vazhdon shqyrtimi në komisionin përgjegjës.

Fillojmë me çështjet e rendit të ditës.

Nga Këshilli i Ministrave janë depozituar dy projektligje, njëri prej të cilëve është kërkuar të shqyrtohet me procedurë të përshpejtuar. Votimi i tij do të bëhet së bashku me çështjet e tjera të rendit të ditës.

Gjithashtu, janë depozituar nga Këshilli i Ministrave kandidaturat për anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Ju njoftoj se nga deputetët e Grupit Parlamentar të LSI-së janë depozituar 2 projektligje: njëri propozon amendimin e ligjit "Për buxhetin e vitit 2019" dhe tjetri propozon amendimin e ligjit për arsimin e lartë. Për këtë arsye kryetari i Grupit Parlamentar të LSI-së, zoti Vasili, në mbështetje të nenit 31 të Rregullores, ka bërë një kërkesë për ndryshimin e rendit të ditës së seancës plenare të datës 13 dhjetor 2018 për shqyrtimin e këtyre dy nismave brenda kësaj date.

Urdhëroni!

Keni tri minuta kohë!

Kejdi Mehmetaj – Faleminderit!

Së pari, më lejoni të jem shumë e qartë për arsyen e vetme që na solli në seancën e ditës së sotme të parlamentit, mua dhe kolegët e LSI-së, kjo arsye janë të rinjtë shqiptarë. Ne jemi këtu për ata mijëra studentë që sot, në ditën e nëntë apo të dhjetë të protestës së tyre, nuk gjenden vetëm para Ministrisë së Arsimit, as vetëm përpara Kryeministrisë, por edhe përpara parlamentit, për të na bërë të qartë se po presin

një zgjidhje prej nesh. Kjo zgjidhje nuk u dha as nga arroganca, as nga malinjteti, që qeveria dhe deputetët treguan në këto ditë.

Ne jemi krenarë më shumë se kurrë për këta të rinj, që po i kthejnë shpresën Shqipërisë, që po na bëjnë të kuptojmë se ka një realitet ndryshe nga ky i qeverisë, e cila ka në mendjen e saj vetëm projekte jo të mira për këtë vend, vetëm projekte për t'i larguar të rinjtë shqiptarë dhe që në mendjen e saj paratë e shqiptarëve, paratë e buxhetit të shtetit i ka për koncesionet, për PPP-të, nuk i ka për të rinjtë dhe për edukimin e tyre.

LSI-ja përherë në thelb të qëndrimit të saj ka pasur forcën e të rinjve, mbështetjen për të rinjtë dhe veprimin për t'i bërë të rinjtë që ata të ecin përpara të sigurt në rrugën e tyre drejt së ardhmes. LSI-ja është për një edukim më cilësor, sepse vetëm nëpërmjet një edukimi më cilësor do të kemi në të ardhmen një ekonomi më të fortë, do të kemi të rinj të përgatitur për tregun e punës, dhe mbi të gjitha, nuk do të kemi një numër kaq të lartë të rinjsh, që duan të ikin nga Shqipëria.

Këto amendime që ne kemi propozuar pa dyshim nuk janë zgjidhja e vetme dhe as përfundimi i një çështjeje, që duhej të kishte ardhur nga politika, por diti të vinte shumë mirë nga studentët dhe nga të rinjtë.

Ky është vetëm fillimi i plotësimit të 8 kërkesave, që prej 10 ditësh mijëra studentë shqiptarë po i bëjnë rrugëve të Tiranës.

Sot ata duhet ta shihnin këtë parlament si partner, por, në fakt, po e shohin si armikun e tyre kryesor, sepse ky parlament prej kohësh nuk po udhëhiqet nga e mira, por po udhëhiqet nga korrupsioni, nga krimi dhe nga dashakeqësia.

Ne kemi propozuar dy projektligje; i pari ka dy ndërhyrje në ligjin "Për buxhetin e vitit 2019", për të dyfishuar zërat në arsimin universitar dhe për të dyfishuar zërin për kërkimin shkencor dhe për krijimin e një fondi emergjence për t'i nxjerrë studentët nga gjendja e mjerueshme ku ata ndodhen në konviktet e Qytetit Studenti, ku, siç e keni dëgjuar, mungojnë uji, ngrohja dhe të gjitha kushtet bazë për të jetuar dhe jo më për të studiuar.

Po ashtu, kemi propozuar edhe një projektligj për disa ndryshime ose disa amendime në ligjin për arsimin e lartë, në mënyrë që kërkesat e studentëve për...

(Bie gongu)

Gramoz Ruçi – Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, uluni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, ju lutem!

Nuk ka për procedurë. Procedura është kur do të flasë një pro dhe një kundër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Tani nuk jemi në miting. Kush e do fjalën? Një pro dhe një kundër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Jo, nuk ka për procedurë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Zonja e parashtrori kërkesën. Kush e do fjalën? Një pro dhe një kundër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të mbarojë kjo njëherë. Nuk ka për procedurë, sepse procedura është e përcaktuar në Rregulloren e Kuvendit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për t'u shprehur pro?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, merreni fjalën!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Sipas Rregullores, fjala merret për t'u shprehur pro.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vazhdo, vazhdo!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kam lexuar Rregulloren.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vazhdo! Nuk ndërhyhet më!

Urdhëroni, për të mbështetur nismën ose kërkesën!

Luçiano Boçi - Të nderuar deputetë,

Ne jemi sot në këtë parlament të rrethuar nga zemërimi studentor, së pari, për të shprehur mbështetjen tonë për protestën e studentëve, të cilët janë ngritur kundër sistemit, jo kundër demokracisë, por kundër sistemit oligarkik qeverisës, kundër grabitjes dhe zhvatjes që po u bëhet atyre dhe familjeve të tyre, kundër kësaj bande babëzie, që i ka hedhur ata sot në rrugë dhe nuk u jep një përgjigje. Prandaj jemi sot këtu, për të dhënë mbështetjen për ta, por, njëkohësisht, jemi për të dhënë mbështetjen për

iniciativën e amendimeve që ka ndërmarrë aleatja jonë, LSI-ja.

Megjithatë, ne mendojmë se të gjitha llojet e amendimeve mund ta shërojnë gripin. Propozimet e tyre për rritjen e buxhetit do t'i dëgjoni shumë mirë, zoti Braçe. Propozimet e tyre ne i dimë shumë mirë dhe ju duhet t'i dëgjoni, megjithatë ato mund të shërojnë gripin e stinës, gripin e dimrit. Ato janë propozime që vijnë nga një parti, nga opozita. Ju dëgjojeni me vëmendje, por ato nuk mund ta shërojnë dimrin kanceror, që ka pushtuar sot universitetet e Shqipërisë, që ka pushtuar sot arsimin e lartë, atmosferën e pedagogëve dhe studentëve. Prandaj, dëgjojeni me vëmendje!

Megjithatë, unë e përsëris qëndrimin tonë të përbashkët, që e ka shprehur edhe kryetari i PD-së: ne jemi për abrogimin e ligjit për arsimin e lartë. Këtë e kemi thënë që në vigjilje të miratimit të tij, sepse nga këtu ka nisur e keqja. Ne jemi për zëvendësimin e tij me një ligj, që u përshtatet studentëve, që zhvillon arsimin, që garanton me ligj shkurtimin e tarifave, autonominë reale të universiteteve dhe rolin thelbësor që kërkojnë sot studentët dhe ju nuk doni t'ua jepni. Ky është qëndrimi ynë. Ky qëndrim është i saktë dhe i prerë.

Nuk mund të vazhdohet më kështu! Qytetarët janë kundër kësaj qeverisjeje. Ata janë kundër këtij Kryeministri sharlatan, kundër këtij parlamenti kukull. Ata do të vazhdojnë, sepse gjithçka nis pikërisht me qëndrimet nga ky parlament dhe nga kjo qeverisje.

Ju bëj thirrje që ta abrogojmë së bashku ligjin për arsimin e lartë, në qoftë se keni vullnet dhe dëshirë.

(Bie gongu)

Gramoz Ruçi – Koha mbaroi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem!

Fjalën e ka zoti Balla!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Minimumi ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Qetësi, zoti Braçe!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Keqardhje.

Të lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Minimumi që mund të them është se s'paska përfituar as profesori i tyre nga qetësia, matura dhe kultura e studentëve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem!

Të dëgjojmë zotin Balla!

Taulant Balla - Faleminderit!

Një ndër kërkesat e ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, Erion!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një ndër kërkesat e studentëve është edhe adresimi i korrupsionit në arsim, por, sigurisht, korrupsioni në arsim do të adresohet, Petrit, edhe me profesorë të denoncuar për korrupsion në arsim.

Më lejoni të përsëndes, së pari, daljen nga ilegaliteti të një pjese të opozitës, e cila ishte fshehur mes studentëve.

Edhe personi që iku, ka qenë këto ditë i fshehur mes studentëve, i maskuar mes tyre, gjoja për mbështetjen e kërkesave të studentëve, kur, në fakt, një prej kërkesave të studentëve është pikërisht ajo që thashë unë, dhënia fund korrupsionit në arsim.

Dua ta them troç në emër të Grupit Parlamentar të PS-së, se të gjitha kërkesat e studentëve do të plotësohen një për një, por jo në dialog me ju, se ju nuk e keni tagrin e as nuk e dini se si do të realizohen. Ato do të plotësohen vetëm me dialog me ata që meritojnë të gjithë respektin e këtij Kuvendi dhe të këtij kombi, me studentët, që sot janë në protestë. Prandaj Kryeministri ka iniciuar një proces, i cili, sigurisht, do të shkojë, hap pas hapi, deri në fund nëpërmjet dialogut dhe zgjidhjes përfundimtare jo të tetë pikave, por të më shumë se kaq, për të çliruar njëherë e përgjithmonë një sëmundje të vjetër në universitetet tona, që ne ende nuk kemi arritur ta zgjedhim në këta pesë vjet qeverisje.

Ne jemi të vetëdijshëm që nuk kemi bërë ende sa duhet për t'i zgjidhur të gjitha problematikat që kanë studentët, pra jo vetëm këto pikat, jo vetëm kushtet e konvikteve; jo vetëm kushtet e shkollave dhe të universiteteve, por, sigurisht, edhe problematikat që lidhen me kurrikulat, me mënyrën e përlogaritjes së krediteve, me performancën, edhe me performancën e stafit akademik, e të gjitha me radhë.

Së dyti, si ka mundësi që guxoni të talleni me ata që janë në shesh, edhe në formë të një kërkesë?! Por, si ta ndryshoj unë buxhetin, Petrit, kur buxheti është tek Ilir Meta? Buxheti sot është tek Ilir Meta, nuk është këtu, është te Presidenti i Republikës!

(Bie gongu)

Të gjithë e dini se procedura e ndryshimit të buxhetit është një procedurë që nuk bëhet me dy gisht letër. Por, kjo është tallje, 28 vjet tallje. Madje doni të bëni edhe 28 minuta tallje këtu, në sallën e Kuvendit! Por ne nuk tallemi me ta, ne e kemi nisur procesin! Të jeni të sigurt që ky proces dialogu do të...

(Deputetit Balla i mbaron koha e fjalës.)

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Balla!

Po, zoti Vasili, për replikë.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Ju lutem!

Petrit Vasili – Jemi në këtë sallë, në radhë të parë, për të adresuar ato kërkesa dhe atë debat publik, i cili nuk është ndërmjet nesh dhe studentëve, por është ndërmjet studentëve, atij që është atje dhe të gjithëve ju së bashku, që e mbështesni! Kjo nuk diskutohet. Në qoftë se do të duan të bëhen palë protestuesit dhe ata ndaj të cilëve protestohet, këtu jemi në ato nivele, tashmë të njohura, të një idiotësie politike, e cila ka vendosur që ta zgjidhë dialogun me monolog. Monologu vjen ose nga kushtet e vështira politike, ose nga kushtet shumë të vështira psikike, por në të gjitha rastet është një kapsllëk politik nga i cili nuk e çlirojmë dot as Kryeministrin, as këdo tjetër që merr fjalën sot.

Së fundi, buxheti i shtetit, i cili është miratuar një javë ose tetë ditë më parë, ka qëndruar një javë në zyrat e Kuvendit apo në zyrat e ministrive për të riqepur dhe shqepur tabelat e fëlliqura. Por përpara një emergjence kombëtare ky parlament e ka bërë dhe e ka ndryshuar Kushtetutën brenda natës. Kanë qenë këta zotërinjtë që e kanë bërë këtë punë dhe pa iu dridhur qerpiku fare kanë duartrokitur dhe janë hedhur përjetë!

Atje janë mijëra djem e vajza, që, në radhë të parë, nuk kanë nevojë të dëgjojnë monologje idiote, por kanë nevojë për zgjidhje dhe këto zgjidhje janë këtu, në këtë sallë.

Kush u ikën këtyre zgjidhjeve, do të marrë përgjegjësinë përpara tyre. Këtyre zgjidhjeve nuk u iket me parabola procedurale, por me veprime dhe aksion politik. Kush u ikën, do të marrë përgjegjësi një nga një dhe nuk e ndan dot përgjegjësinë me asnjërin nga ne, sepse ju jeni shkaku dhe po ju keni detyrimin t'u jepni zgjidhje. Po i ikët këtij detyrimi, do të merrni një përgjegjësi të pashlyeshme për ata djem e vajza që rrinë në të ftohtë atje dhe protestojnë për minimumin bazik, për të pasur disa banja më shumë...

(Deputetit Vasili i mbaron koha e fjalës.)

Gramoz Ruçi – Faleminderit!

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Jo, ju lutem, zoti Kryeministër!

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Një minutë, të mbarojmë me votimin e kësaj çështjeje, pastaj mund ta merrni fjalën!

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Zotërinj deputetë, lidhur me kërkesën e paraqitur nga zoti Vasili, për të ndryshuar rendin e ditës, dua të sqaroj se nuk është në përputhje me Rregulloren.

Së pari, propozimet për buxhetin e vitit 2019 nuk mund të bëhen, pasi projektligji për buxhetin vërtet ka kaluar në datën 3 në seancë, por ai ndodhet ende te Presidenti, pasi nuk është dekretuar ende prej tij. Ai në datën 1 janar hyn në fuqi dhe vetëm atëherë mund t'i bëhen amendime.

Së dyti, të dyja projektligjet e propozuara, në mbështetje të pikës 1 të nenit 69 të Rregullores, nuk mund të futen në seancë plenare, pra në kalendar, pa kaluar, sipas kësaj pike dhe këtij neni, dy javë nga data e paraqitjes.

Së treti, Rregullorja e Kuvendit e përcakton qartë procedurën ligjvënese: "Projektligji përfshihet në programin e punës së Kuvendit dhe në kalendarin trijavor në momentin e hartimit të tyre, duke përcaktuar komisionet që do ta shqyrtojnë projektligjin". Ne jemi në fazën që të dyja projektligjet janë depozituar, por ende nuk janë përcaktuar komisionet nga seanca plenare. Pra, me pak fjalë, propozimi i bërë nuk përmbush kërkesat e Rregullores. Megjithatë, unë e hedh në votim. Kush është dakord me kërkesën...?

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Të lutem, të lutem!

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

E doni fjalën për procedurë?

Kështu e kanë rregullat, zoti Kryeministër!

Luan Rama – Faleminderit, zoti Kryetar i Kuvendit!

Më lejoni të theksoj që sot nuk është një ditë e zakonshme dhe Kuvendi nuk mund ta trajtojë të gjithë atë që po ndodh jashtë sallave të këtij Kuvendi si një çështje procedurash, e para.

E dyta, protesta e studentëve, revolta e studentëve është në thelb treguesi më i mirë i produktit politik të të gjithë klasës politike të këtij vendi në njëzet e shtatë vjet dhe është produkti më akuzues i qeverisjes së këtij vendi. Kjo do të thotë që të gjithë ne këtu, pavarësisht ngjyrës politike apo krahut që përfaqësojmë, duhet të ndihemi të turpëruar, të ulim kokën, t'u kërkojmë ndjesë atyre studentëve dhe të harrojmë për një çast se çfarë mandati partiak kemi këtu për t'u ngritur të paktën në nivelin e qytetarisë, të kulturës dhe të rezistencës së atyre studentëve atje. Pikërisht, kjo është arsyeja pse ne jemi sot në këtë sallë, që t'i bëjmë thirrje vetes sonë: të ulim kokën e t'u kërkojmë atyre ndjesë dhe të reflektojmë, jo duke u kapardisur, as duke u mburrur me numrin e kartonëve apo me postet që mbajmë, por, së pari, të mendojmë se ata janë djem dhe vajza nënash; janë djemtë e këtij vendi, që janë atje për shkak të përgjegjësisë sonë; të të gjithëve ne!

Më lejoni t'ju shoh në sy kolegë deputetë të Partisë Socialiste, dhe të shoh te secili prej jush fytyrën e vërtetë, dimensionin njerëzor, solidaritetin, për të cilin kemi folur në 27 vjet, dhe hajdeni ta shfaqim këtë sot, si reflektim! Le t'i lëmë procedurat! Le të rrijë Kuvendi i mbledhur sot, nesër, pasnesër, këtu në mjediset e Kuvendit, në komfortin e kondicionerëve në kontrast me rrugën ku qëndrojnë ata, dhe të legalizojmë që tani atë që Kryeministri thotë se është dakord.

Je dakord? Dakord. Hajdeni të miratojmë ndryshimet në ligj, të legalizojmë atë që kërkojnë studentët dhe pastaj të ecim më tej! Përndryshe, studentët kanë të gjithë të drejtën e Zotit të na nxjerrin të gjithëve jashtë, duke filluar nga ky Rama këtu, deri te Rama këtu!

(Bie gongu)

Të na nxjerrin jashtë, sepse jemi të padenjë...

(Deputetit Rama i mbaron koha e fjalës.)

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Rama!

Zoti Kryeministër...

Vetëm tri minuta.

Edi Rama – Pse tri minuta?

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Gramoz Ruçi – Jo, ju lutem!

(Kryeministri Rama flet nga vendi pa mikrofon.)

Në qoftë se do ta merrni fjalën, do të flisni vetëm tri minuta.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Fjalën e ka zoti Rama, tri minuta.

(Debat në sallë)

Do të flasë për procedurë, tri minuta.

Salianji, uluni poshtë!

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Deputeti Salianji, uluni poshtë, ju lutem!

(Deputeti Salianji flet nga vendi pa mikrofon.)

Uluni poshtë!

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Deputeti Salianji, uluni poshtë!

(Një deputete e opozitës flet nga vendi pa mikrofon.)

Deputeti Salianji, uluni poshtë!

Uluni poshtë, ju lutem!

(Deputeti Salianji flet nga vendi pa mikrofon.)

Uluni poshtë!

Kryeministri do të flasë për tri minuta.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Ju lutem! Secili ka të drejtë të flasë. Madje Kryeministri e ka kërkuar fjalën para zotit Luan Rama.

Edi Rama – Mund të fillojë koha ime tani?

(Debat në sallë)

Gramoz Ruçi – Mund të filloni, zoti Rama.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Edi Rama – Adashi im me mbiemër, Rama Luan, tha: “Studentët kanë të drejtë të na nxjerrin të gjithëve jashtë”, ndërkohë që juve ju kanë nxjerrë jashtë, sepse...

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

...u detyruat të hidheni në ilegalitet dhe ta ndikoni protestën të maskuar.

Tani, për të mos humbur kohë, së pari, dje janë formuar organet e para të drejtësisë së re, Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor, pasi u krijua edhe Këshilli i Emërimeve në Drejtësi.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Ndërkohë, për sa u përket propozimeve të këtyre, nuk është as çështje procedurale, as çështje buxheti, që është te Presidenti, propozimet e këtyre janë të refuzuara, sepse janë propozime të bëra për të mos u bërë kurrë!

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Tani, leximi im i protestës së studentëve është shumë shkurt.

E para, protesta i dha një shuplakë qeverisë.

E dyta, protesta i dha një grusht opozitës.

E treta, protesta i dha një shpresë shoqërisë.

(Duartrokitje në sallë)

Shoqëria kërkon zgjidhje dhe shoqëria nuk mund ta pranojë që zgjidhja të vijë me porosi nga doktoresha e shkencave Monika Kryemadhi, nga profesor Lulzim Mziu apo nga profesor Qorri. Zgjidhja vjen me dialog.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Opozita kërkon vetëm bllokimin e zgjidhjes, sepse kërkon që t'i nxjerrë gështenjat nga zjarri duke futur studentët në qorrsoak. Ndërsa qeveria e ka zgjidhjen dhe do ta japë me dialog.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Pse na duhet dialogu? Për shembull, ka një pikë aty që thotë: vetingu i titujve.

(Bie gongu)

Ne e kemi në plan si duhet bërë kjo, por duhet rënë dakord për planin.

Një gjë di unë, që brenda gjashtë muajve të ardhshëm kryetarja e Lëvizjes Socialiste për Integritet do të jetë “doktoresha e parë e shkencave”, e cila do të heqë bluzën e doktorit dhe do të mbetet me çizmen e Lëvizjes Socialiste për Integritet.

(Duartrokitje nga salla)

Gramoz Ruçi – Atëherë, kush është dakord me propozimin? Kundër? Abstenim?

(Votimi zhvillohet me kartonë. 4 deputetë janë “pro”, 72 janë “kundër”)

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Nuk miratohet propozimi.

Vazhdojmë me rendin e ditës.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Kush është dakord me procesverbalet e datave 22.11.2018 dhe 03.12.2018?

(Një deputete e opozitës flet nga vendi pa mikrofon.)

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet procesverbali.

Vazhdojmë me rendin e ditës, me projektligjin “Për investimet e huaja”, i ndryshuar””.

Fjalën e ka zonja Evis Kushi.

Evis Kushi – I nderuar Kryetar,

Të nderuar kolegë,

Projektligji që do të votojmë sot propozon një ndryshim në ligjin ekzistues për investimet e huaja, i cili ka në fokus mbrojtjen e posaçme për investimet apo investitorët e huaj në Shqipëri. Konkretisht, afati i fundit ligjor për këtë mbrojtje të posaçme ka qenë data 31 dhjetor 2018 dhe me ndryshimin e sotëm ky afat shtyhet nga fundit i këtij viti deri më 31 dhjetor 2019.

Ky ndryshim vjen pas ndryshimit që ne bëmë në ligjin për investimet strategjike, ku shtymë me 1 vit afatin e aplikimeve të investitorëve të huaj për të marrë statusin “investitorë strategjikë”. Arsyeja pse ne po e zgjasim vetëm 1 vit është se nga institucionet përgjegjëse po punohet për të hartuar një ligj të ri gjithëpërfshirës, të unifikuar për investimet e huaja dhe strategjike. Natyrisht, ky ligj, brenda vitit 2019, do t’i kalojë të gjitha etapet e tij që nga draftimi, konsultimi me grupet e interesit, hartimi dhe miratimi në Kuvendin e Shqipërisë. Por e rëndësishme është, këtë mos ta harrojmë, që çdo ndryshim i kuadrit ligjor duhet të garantojë qartësi, transparencë dhe parashikueshmëri për çdo investitor të huaj që më pas sjell ndikim në rritjen e investimeve të huaja, në rritjen e punësimit, në rritjen ekonomike dhe në rritjen e konkurrencës së ekonomisë sonë.

Ndërkohë, dua të përftoj nga rasti të them dy fjalë për investimet e huaja në Shqipëri. Legjislacioni shqiptar është një legjislacion liberal në këtë drejtim në krahasim me disa vende të tjera dhe në rajon, duke u mbështetur kryesisht në parimin e mosdiskriminimit midis investitorëve të huaj dhe investitorëve vendas. Disa vende të tjera të rajonit nuk kanë një ligj specifik për investimet e huaja, ndërkohë që ne e kemi këtë ligj dhe e kemi me një sërë mekanizmash mbrojtës për investitorët e huaj.

Gjithashtu, dua t’ju theksoj edhe faktin që vitet e fundit janë ndërmarrë shumë iniciativa ligjore kryesisht fiskale për të nxitur investimet e huaja në Shqipëri. Një shembull shumë i mirë është rasti i investimeve të huaja në fushën e turizmit për hotelet “brand name” me 4 dhe 5

yje, për të cilat ne kemi ulur edhe tatimin mbi vlerën e shtuar dhe tatimin mbi të ardhurat.

Së fundi, dua t’ju them dy fjalë për protestën. Si deputete, por edhe si pedagogë e mbështes protestën e studentëve, sepse e di shumë mirë që kërkesat e tyre në pjesën më të madhe janë të drejta dhe të arsyeshme. Problematikat e arsimit të lartë i njoh, ku shumica e tyre, për të mos thënë të gjitha, janë problematika të trashëguara dhe të akumuluar ndër vite. Një pjesë e tyre janë zgjidhur, një pjesë e tyre akoma po trajtohen dhe një pjesë e tyre natyrisht janë në objektivin kryesor të punës sonë të ardhshme.

Po ashtu, i mirëkuptoj studentët deri diku kur e refuzojnë dialogun, sepse mendojnë që kërkesat e tyre janë minimale apo që qeveria i ka detyrim. Janë ende të rinj dhe shumë gjëra do t’i mësojnë me kalimin e kohës, por nuk mund t’i mirëkuptoj as pedagogët e tyre, as prindërit e tyre dhe as qytetarët e tjerë të përgjegjshëm, adultë, që i mbështesin studentët në qëndrimin e tyre kundër dialogut, kundër bashkëpunimit. Si mundemi ne t’u indukojmë të rinjve dhe të rejave, fëmijëve tanë, këtë lloj kulture kundër dialogut, kundër bashkëpunimit, kundër mirëkuptimit. Absolutisht jo!

Unë e kuptoj shumë mirë që një pjesë e mirë e kërkesave të studentëve mund të zgjidhen në një kohë më të shkurtër, por një pjesë tjetër nuk mund të zgjidhen sa hap e mbyll sytë, brenda natës, sepse kanë nevojë për diskutim, për dialog, kanë nevojë për afate dhe ne kemi vullnetin maksimal për t’i zgjidhur këto probleme.

Të dashur studentë, në këtë kauzë jemi bashkë, në këtë kauzë jemi të gjithë aleatë, prandaj sa më parë të ulemi të dialogojmë dhe t’i zgjidhim problemet. Problemet kanë zgjidhje dhe në qoftë se jemi bashkë, do t’ia dalim.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi - Këtu mbyllet diskutimi për projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr. 7764, datë 2.11.1993, “Për investimet e huaja”, të ndryshuar””.

Para se të kalojë te projektligji për turizmin, fjalën e ka kërkuar ministri i Brendshëm, zoti Lleshi.

Sandër Lleshi – Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

E mora fjalën për të bërë vetëm një ndërhyrje të shkurtër që ka lidhje me protestat e studentëve. Gjatë ditës së djeshme që herët në mëngjes ka qarkulluar një lajm për fillimin e procedurave penale ndaj disa studentëve dhe pedagogëve pjesëmarrës në protestat e zhvilluara këto ditë në vendin tonë.

Ky lajm ka gjetur një jehonë të gjerë mediatike, publike dhe ka pasur diskutime dhe elaborime të shumta, ku edhe miq të mi në radhët e profesorëve më kanë shqetësuar dhe lidhur me pakuptimësinë e këtij lajmi apo të kësaj ndërhyrjeje të policisë. Në momentin më të parë që gjeta kohën për t'u marrë me këtë çështje, i kam kërkuar Policisë së Shtetit informacione të detajuara rreth kësaj ndërhyrjeje apo procedimi dhe për befasinë time të madhe rezultoi se lajmi është plotësisht i pavërtetë.

Dje nuk ka pasur kurrfarë procedimi penal ndaj asnjë pedagogu apo studenti pjesëmarrës në protestat e vendit. Kjo është lehtësisht e provueshme. Nëse dikush do të kishte marrë mundimin të interesohej pranë organeve të prokurorisë apo përmes avokatëve përkatës, do të ishte sqaruar.

Edhe një herë po jua përsëris, kjo më shumë për opinionin publik, nuk ka pasur asnjë lloj procedimi penal ndaj asnjë pedagogu apo studenti pjesëmarrës në protestat e ditëve të fundit të zhvilluara në Tiranë apo në qarqet e tjera të vendit.

Sigurisht, pas këtij konstatimi kam filluar procedurat për të nxjerrë përgjegjësinë ndaj atyre personave përgjegjës në Policinë e Shtetit, të cilët nuk kanë ndërmarrë hapat e nevojshëm për ta përgënjeshtuar këtë lajm, i cili mori vëmendje të madhe publike, duke ngatërruar gjithçka.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Ministër!

Kalojmë te projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr. 93/2015 “Për turizmin”, të ndryshuar”.

Fjalën e ka zoti Nasufi.

Më fal, zoti Nasufi, fjalën e ka kërkuar Kryeministri.

Edi Rama – Ngaqë nuk munda të jem shterues për shkak të kohës së kufizuar në ndërhyrjen e parë, ndërkohë që parlamenti vazhdon sipas axhendës së parashikuar, mendoj se të gjithë ata që janë të interesuar në mënyrë të sinqertë për t'i dhënë zgjidhje një situatë krejt

absurde, ku njëra palë ka shtruar disa kërkesa dhe pala tjetër jo vetëm që nuk i ka refuzuar ato, pra qeveria, por përkundrazi është e gatshme t'i zgjidhë një për një, janë të ftuar në çdo moment edhe këtu në këtë sallë, nëse dëshirojnë që të diskutojnë hapur në sytë e të gjithë opinionit publik lidhur me 8 pikat e studentëve, por edhe më shumë se kaq, kjo sallë është në dispozicion.

Faktikisht, opozita reale e vendit sot janë ata studentë që kanë vendosur të ngrenë krye kundër një sistemi brenda universitetit që i ka marrë ata peng. Në të njëjtën kohë na kanë dhënë një shuplakë për të na shkundur dhe për të na bërë që t'i hapim sytë më shumë dhe t'i fokusojmë më shumë tek ajo që ndodh brenda mureve të universitetit.

Ky parlament dhe çdo sallë në këtë qytet apo në çdo qytet tjetër ku ka universitet janë hapësira ku ne mund të diskutojmë. Unë jam i gatshëm këtu dhe kudo që studentët duan, të diskutoj me ta, jo për t'i torolisur, as për t'i futur në një rrugë pa krye dhe as për të mbyllur protestën. Unë nuk dua që protesta të mbyllet, sepse kjo protestë, e cila afishon 8 pika, i ka rrënjët shumë më thellë, i ka rrënjët thellë, te burimet e sëmundjes së universitetit, tek ajo sëmundje të cilën autonomia e shumëkërkuar dhe e dhënë për herë të parë nga shumica socialiste i ka mbuluar dhe nuk ka lejuar kurimin e tyre.

Është shumë e thjeshtë, këtë dua t'jua them të gjithëve, për mua, për ne, që ta trajtojmë këtë protestë si një çështje procedure dhe si një çështje ofertë-kërkese apo si çështje porosish në derën e një dyqani. Këtu nuk bëhet fjalë për kilogramë mish, për thasë me patate apo për arka me mollë, këtu bëhet fjalë për të hapur një proces që fillon nga këto pika. Të gjithë atyre që thonë “plotësoji pikat”, u them se ne jemi gati t'uua plotësojmë pikat një për një, por ata që erdhën këtu si përfaqësues të opozitës së maskuar, të opozitës së hedhur në ilegalitet, një opozitë që nuk ka mundësinë të dalë dhe të mbështesë një protestë studentore, sepse në momentin që e mbështet, e njollos. Përfytyrojeni se çfarë opozite është, një opozitë që vrapon për t'u futur mes jelekëve portokalli tek Astiri, se nuk ka kurajën të dalë dhe t'i thotë popullit që unë jam me studentët, sepse e ha mbrapsht flakërimin, ashtu sikundër askush nuk do ta dëshironte në politikë.

E pra, pyetja këtu është: çfarë fshihet pas bllokimit të dialogut? Kjo është e padëgjuar. Çfarë fshihet pas gjithë asaj propagande të shfrenuar, që investohet nga ndërmarrja e doktoreshës dhe nga SHQUP-i këtu dhe nga ai profesor Qorri, i cili thotë: “Në asnjë mënyrë dialog!”? Fshihet qëllimi që këto kërkesa të mos zgjidhen, që studentët të acarohen në mënyrë sa më artificiale dhe të futen në qorrsohakun ku i do kjo opozitë, e cila ka kohë që ka humbur zgjedhjet, që premtion revolucion, kërcënon me destabilizim, kërcënon për kaos dhe kërcënon me djegie, opozitë që shpërndante mesazhet që të martën pas pushimeve do të iki qeveria ose do të digjet Tirana. Çfarë fshihet?

Kjo është e padëgjuar dhe kjo është arsyeja pse unë refuzoj që këto 8 pika t'i plotësojmë sikur janë porosi për një dyqan. Në momentin që ne e themi këtë, jo përballë studentëve dhe jo bashkë me studentët, menjëherë e gjithë makineria e manipulimit, e cila nuk është vetëm ajo e partive, por edhe ajo e klubeve të natës, e atyre që gdhien në mëngjes duke shpresuar që të digjet fshati dhe në mbrëmje shkojnë krihen para ekraneve, do të thotë: jo, nuk janë këto, sepse pikat nuk janë vetëm “çfarë”, pikat janë edhe “si”.

Pika e parë nuk është vetëm përgjysmimi i tarifave, por edhe si do të përgjysmohen tarifat dhe në momentin kur do të hyjmë te “si”-ja, e gjithë industria e manipulimit do të vihet në lëvizje. Nuk është çështja a duam apo nuk duam të bëhet pastrimi i universitetit nga gjithë ajo farsë, që rëndon mbi supet e të gjithëve, e titujve, të bazuar jo mbi studime shkencore, por mbi korrupsion, mbi kopje, mbi mashtrime, çështja është te “si”-ja.

Ne jemi të përgatitur jo vetëm për “çfarë”, por edhe për “si”, por duhet ta diskutojmë këtë me studentët. Duam ta diskutojmë me studentët në sytë e publikut, që të jemi të qartë që këtë thamë e këtë bëmë, jo nga ballkoni: “thellohu – thellohu”. Ky është qëllimi dhe të gjithë studentët duhet ta kuptojnë këtë.

Më falni shumë, por kur kam parë dje një video nga diskutimi në Fakultetin Ekonomik, ku studentët e mbledhur aty kërkonin të binin dakord dhe të kishin konsensus për të hapur dialogun, studentëve u fliste një fantazmë e Partisë së Punës, e pjesës më vulgare të Partisë së Punës, një doktor shkencash, që doktoraturën

e ka bërë me titullin “Eficiencia e kalit në ekonomi” (është titull doktorature, nuk është poezi satirike), një personazh, me të cilin nuk kam asgjë personale, që unë e dija tanimë në botën tjetër dhe aq shumë u habita, sa besova që më bënë sytë, një personazh që përfaqëson gjithçka që ne nuk mund ta gëlltisim më kur dolëm në vitin '90 kundër regjimit. Fytyra e mediokritetit, e gjithë hipokrizisë dhe e gjithë farsës së atij regjimi u flet studentëve sot me megafon dhe u thotë pse nuk duhet të dialogojnë me Kryeministrin e vendit.

O Zot, në fakt, nuk është sot dita për të kërkuar dialog, sot është dita për t'u lutur për studentët, për t'u lutur që këta djaj me brirë të mos bëjnë më aq dëm, sa kanë bërë gjithë këto vite! Kryetari i Komitetit Kombëtar të Turizmit është një i nxjerrë nga ato kallëpet e djathit kaçkavall si komunist dhe i kthyer në socialist, që çonte letra sekrete për të stimuluar prodhimin e bulmetit në hotel-turizëm dhe orientonte hotel-turizmin që t'i blinin produktet te vëllai i vet në Përmet. Letër sekret. Kam dëshmitarë për këtë, i kam dëshmitarët kryeministra.

Më falni, ku jetojmë, në çfarë pike kemi arritur?! Në fund të vitit 2018 diskutojmë a duhet të flasim apo nuk duhet të flasim! Dhe më e bukura me mua është që, kur unë dua të flas, thonë: jo, ti nuk duhet të flasësh. E pse nuk duhet të flas? “Sepse na mbush mendjen”. Përgjigja “se na e mbush mendjen” është një çmenduri. U thonë studentëve: “Mos flisni me atë, se do t'ju çorodisë, do t'ju gënjejë, do t'ju bëjë magji...”

Ne nuk kemi ardhur këtu të tallemi. Ne s'kemi ardhur këtu as të bëjmë “sikur”. Sudja thoshte: “Sot, të gjitha”. E mbani mend se çfarë u tha në fund? “Ishte loja”. “Sudja” tjetër, doktoresha e shkencave, thotë: “Sot, të gjitha”, por ajo nuk thotë: “ishte loja”, thotë: “loja vazhdon”. Kurse ne themi “Sot për të ardhmen”, sepse kjo lojë duhet të mbarojë! Kjo është ajo që ne themi.

Të gjithë ata që më dëgjojnë duhet ta dinë, t'i marrin pikat, t'i numërojnë nga e para tek e fundit, ne jemi gati t'i plotësojmë një për një. Po kujt t'ia themi? Ylli Kadriut, apo Çimi.net Kadriut?

Me kë të flasim?!

Duhet të flasim drejtpërdrejt me studentët. Nga ky dialog duhet të dalë një marrëveshje e kalendarizuar, ku për çdo pikë të merren

përgjegjësi dhe përgjegjësit e ngarkuar nga marrëveshja të përgjigjen për zbatimin ose moszbatimin e çdo pike.

Unë nuk mund ta parafytyroj dot një situatë në të cilën treçereku i atyre pikave nuk kanë lidhje fare me qeverinë. Nuk kanë lidhje me qeverinë, fare. Treçereku i atyre pikave janë çështje të brendshme të universitetit. Fakti që sot i kërkohe qeverisë, flet shumë. Flet për të vërtetën që shpresa tek universiteti vetë ka vdekur, pikërisht shpresa se forumet brenda universitetit mund t'i zgjidhin këto probleme. Probleme të mëdha shumë!

Çfarë problemi është publikimi *online* i të gjitha shpenzimeve të universitetit? Detyrë e qeverisë është kjo?! Si mund të them unë “po”, pa folur dhe pa ju parë në sy? Por si do të bëhet? Çfarë do bëhet dhe kush do të bëjë çfarë në këtë histori, se mund të them unë “po”, por publikimin e shpenzimeve të universitetit *online* duhet ta bëjë çdo universitet. Dhe kjo nuk ka për të ndodhur nëse mjaftohemi me një “po” për të mbyllur protestën.

Kur pashë atë fantazmën dje, mendova sa shumë është pleksur e gjithë masa e xhagajdurëve që nuk duan zgjidhje.

Nuk duan zgjidhje as ata që janë në opozitë.

Nuk duan zgjidhje as ata që janë përpara pasqyrave në darkë.

Nuk duan zgjidhje as ata që janë brenda universitetit dhe që e ndiejnë se, nëse shkohet përtej 8 pikave, fillon fundi i tyre. Fillon fundi i tyre!

Nëse studentëve u hapet rruga, që jo vetëm të ngrenë zërin, por që zëri i tyre të dëgjohet, atëherë do të jetë shumë më e vështirë t'u kërkohe para për provimet, do të jetë shumë më vështirë t'u kërkohe para për librat. Ku është kjo tek 8 pikat? Kjo nuk është tek 8 pikat.

Është mbledhur e gjithë ajo zonë e jetës shoqërore, e jetës politike, e jetës akademike, e jetës ekonomike të vendit, që do rrëzimin e kësaj qeverie, që nuk ka lidhje fare me studentët që duan të trajtojnë çështjen e diskriminimit të tyre brenda mureve të universitetit.

Kjo është arsyeja pse unë jam këtu, bashkë me ju, në krahun e studentëve.

Unë nuk dua që kjo protestë të mbarojë. Unë dua të jem pjesë e kësaj proteste në vazhdim. Protesta mund të mbarojë në rrugë, por protesta duhet të vazhdojë në çdo universitet, në

formën e një rrjeti të strukturuar njerëzish, që sot nuk e mbyllin këtë sikur janë aty për arsye ekonomike, e një grupi njerëzish që kërkojnë një zgjidhje ekonomike dhe ikin pastaj prapë kokulur dhe futen prapë në një sistem ku nuk kanë dinjitet.

E pra, unë kërkoj dialog jo për të vonuar zgjidhjen, jo për ta zgjatur pafund procesin, por për të hapur një kapitull tjetër bazuar te këto 8 pika. Po jua them prapë për herë të fundit, edhe pse e di që asnjëherë, sado ta përsëris, nuk do të mjaftojë, nëse nuk takohemi sy më sy me studentët që duan zgjidhje, të 8 pikat janë të realizueshme dhe ne jemi gati t'i realizojmë.

E thashë unë tani? Tani, shikoni vazhdimin, “plotëso pikat, ne nuk takohemi”.

Por si i bëhet? Si duhet plotësimi i pikave, në çfarë forme?

Qeveria nuk është sot në konflikt me studentët. Qeveria është sot e gjitha sy e veshë nga studentët.

Unë i falënderoj studentët për shuplakën që i kanë dhënë qeverisë, edhe mua, po të doni. Shuplaka të tilla janë ato që na duhen për t'u bërë më të vetëdijshëm dhe për t'u bërë më të mirë në punën tonë.

Atyre që thonë: “pse tani, nuk e dije ti?!”, u them që demokracia ka lindur pikërisht për këtë dhe është më i miri sistem mes atyre që njohim, pikërisht sepse u jep mundësi të zgjedhurve të çojnë përpara ato për të cilat zotohen, por u jep mundësi edhe zgjedhësve që gjatë gjithë kohës t'i shkundin të zgjedhurit.

Kjo është arsyeja pse unë kam qenë dhe mbetem i mendimit që Shqipërinë e ndan përfundimisht nga këto fenomene vetëm një bashkëqeverisje e vërtetë me njerëzit.

Ky është një moment i madh për ta bërë të vërtetë bashkëqeverisjen, për të mos e mbyllur me 8 pika. Të ulen tarifat? Patjetër! Të bëhet publikimi i të dhënave të shpenzimeve *online*? Patjetër! Të bëhet karta e studentit? Patjetër! Të rregullohen konviktet? Patjetër! Të bëhet deri në fund, ashtu siç kërkohet, çdo pikë? Patjetër! Po pastaj? Pse kaloriferët, tarifat më të ulëta, bibliotekat shkencore, karta e studentit do të zgjidhin problemin themelor që ka universiteti? Kurrë!

Problemin themelor që ka universiteti as nuk e zgjidhin këto, as nuk e zgjidhim dot ne vetë, pasi ne i kemi njohur universitetit

autonominë; as nuk e zgjidhin dot ata rektorë e dekanë, që ende nuk e kanë nxjerrë fytyrën në televizor të thonë çfarë u ka takuar atyre të bëjnë dhe nuk e kanë bërë dhe njëkohësisht të kërkojnë nga studentët, duke qenë të vërtetë e të sinqertë me ta, që të kuptojnë se ku qëndrojnë problemet dhe ku gjenden zgjidhjet e këtyre 8 pikave. As ata nuk e bëjnë dot vetë. Studentët jo e jo. Ndërsa të gjithë bashkë, patjetër po!

Kjo është ajo që unë dua të ndodhë dhe mbajeni mend, kjo është ajo që ka për të ndodhur!

Ata që kanë kujtuar dhe kanë bërë çmos që gjithë atë situatë aspak të këndshme të studentëve ta kthejnë në një zjarr për të nxjerrë gështhenjat për pushtetin e tyre, do të humbasin këtë radhë më keq se ç'humben në vitin 2017 dhe më keq se ç'kanë humbur në të gjitha zgjedhjet. Këtë radhë kjo nuk është me vota. Këtë radhë nuk mund të thonë: "i bletë votat".

Këtë radhë është kush fiton zemrat e studentëve.

Zemrat e studentëve janë aty, për të qenë pjesë e gjakut dhe pjesë e mënyrës së funksionimit të mëtejshëm të kësaj shumice dhe të kësaj qeverie, që duhet të nxjerrë reflektime të mëdha dhe duhet të bëjë ndryshime të mëdha në mënyrën sesi u qaset problemeve, falë kësaj shuplake që ka marrë.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi - Faleminderit, zoti Kryeministër!

Vazhdojmë me diskutimet për projektligjin për turizmin. Fjalën e ka Fadil Nasufi.

Fadil Nasufi - I nderuar zoti Kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Së pari, përshëndes dhe mbështes protestën e studentëve, kërkesat e tyre të ligjshme dhe të arsyeshme. Kryeministrit premtoi përmbushjen e kërkesave të tyre, si dhe reflektimin e të gjithëve ne, ndaj mesazheve që marrim nga kjo protestë, për të ripërcaktuar pozicionin tonë në sjelljen ndaj studentëve dhe ndaj gjithë shoqërisë.

Së dyti, dua të përshëndes ngritjen e strukturave të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor, që i hapën rrugë zbatimit të reformës në drejtësi, si një nga sfidat tona kryesore si maxhorancë.

Duke iu kthyer ligjit për turizmin, është ndryshimi i tretë që i bëjmë ligjit 93/2015 "Për turizmin" në harkun kohor të tre vjetëve.

Ndryshimet ligjore janë rrjedhojë logjike e rritjes së standardeve në sektorin e turizmit dhe presionit të sfidave të konkurrencës në industrinë e turizmit dhe të provës që kemi dhënë në këto vite të qeverisjes sonë, duke e kthyer turizmin në prioritet kombëtar, në motor zhvillimi të ekonomisë dhe në pasaportë kombëtare për promovimin e vendit tonë.

Natyrisht, pas një bilanci prej 5 vjetësh dhe kur fillon viti i gjashtë, krahasimet e treguesve nuk bëhen sesi e gjetëm sektorin e turizmit në vitin 2013, po si kemi ecur dhe ku duhet të mbërrijmë për të qenë në lartësinë elitare të turizmit, sipas pritshmërisë së publikut dhe ekonomisë së vendit.

Transformimet që kanë ndodhur në zonat turistike, investimet në infrastrukturë, vlerësimi me prioritet i zonave me potencial të lartë turistik, restaurimet dhe rrjetëzimi i qendrave historike, i monumenteve të kulturës, që kanë pritshmëri të lartë të fluksit turistik, si dhe nxitja e investitorëve privatë, janë të gjitha në një trend rritës, premtues dhe befasues në produktet që po sjell sektori i turizmit.

Nga janari deri më 30 shtator 2018 në Shqipëri kanë ardhur mbi 5 milionë turistë ose 11,6 % më shumë se në vitin 2017. Vetëm qendrat e trashëgimisë kombëtare u vizituan nga 864 711 vizitorë. Viti 2018 me të drejtë mund të quhet viti i bumit turistik, ku të gjithë treguesit janë më të lartë se pritshmëritë. Të ardhurat nga turizmi arritën vlerën rekord prej 683 milionë eurosh në tremujorin e tretë të vitit 2018, sipas Bankës së Shqipërisë.

Krahasuar me një vit më parë, të ardhurat nga turizmi u rritën me 100 milionë euro. Gjatë këtij sezoni turistik u punësuan mbi 110 mijë vetë. Gjatë 9-mujorit të vitit 2018 të ardhurat nga turizmi ishin 1,47 miliardë euro ose 12% më shumë se viti i kaluar. E gjithë Shqipëria: Valbona, Thethi, Berati, Apollonia, Gjirokastra, Vlora, Saranda, Durrësi, Korça etj. u shndërrua në destinacion turistik si asnjëherë tjetër.

Ndërkohë, tepër të frekuentuara kanë qenë bujtinat, komplekset agro-turistike dhe modelet si Voskopoja, që i paraprijnë programit të "100 fshatrave", si rilindje urbane, rurale, ku komponenti kulturor dhe turistik do të jetë shumë i rëndësishëm.

Së bashku me kolegët e tjerë, deputetët e Komisionit të Edukimit, Medias dhe Informimit

Publik kemi vizituar asetet kulturore të trashëgimisë dhe turizmit në Berat, Gjirokastrë, Butrint, Krujë, Tiranë, Durrës etj. dhe jemi impresionuar që nga rritja me 50-70% e numrit të vizitorëve gjatë vitit 2018 në krahasim me vitin 2017, janë dy- trefishuar të ardhurat nga biletat.

Qendrat e trashëgimisë kanë vjelë 206 milionë lekë të ardhura nga biletat në periudhën janar-shtator 2018, çka flet për mirëmenaxhim dhe përgjegjshmëri të stafëve që punojnë në muzeume, në parqet arkeologjike dhe në qendrat historike.

Me këtë rast, dua të përcjell edhe kërkesën unanime të të gjithë drejtuesve dhe specialistëve të këtyre siteve, që të rishikohet përqindja e të ardhurave në favor të rikthimit në institucionin që i realizon ato, jo në raportin 90% për buxhetin dhe 10% për institucionet siç është sot, çka do të motivojë më shumë stafet dhe do të rrisë investimet për mirëmbajtjen e këtyre institucioneve.

Më 18 dhjetor të vitit 2017 parlamenti miratoi ndryshimin e ligjit nr. 93/2015, që konsiston në dhënien e statusit special për strukturat akomoduese me 4 dhe 5 yje, si dhe në përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për aplikimin për statusin special të investitorëve. Në nenin 6 të ligjit për turizmin thuhet: “Zhvillimi i turizmit nëpërmjet investimeve vendore apo të huaja, në zbatim të këtij ligji, konsiderohet investim publik, duke gëzuar të gjithë mbështetjen dhe lehtësirat e parashikuara në kreun 6 të këtij ligji”.

Në vazhdim të këtij neni, sot bëjmë plotësimin për të mos lejuar lehtësira dhe favorizime që burojnë nga ligji për turizmin: “Për investitorët dhe operatorët, të cilët janë të dënuar me vendim të formës së prerë për kryerje të veprave penale, si dhe për personat që janë anëtarë të një organi administrativ, drejtues, mbikëqyrës apo që kanë kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse dhe kontraktuese”.

Ndryshimi vjen si një domosdoshmëri për trajtimin e fenomeneve shumë problematike të hasura në praktikë gjatë angazhimit serioz të qeverisë dhe maxhorancës për të luftuar kriminalitetin, për t’u prerë rrugën financimeve dhe burimeve të paligjshme. Ky filtrim ligjor shmang përfitueshmëritë dhe favorizimet e personave dhe subjekteve që e kanë burimin e

financimit nga korrupsioni, mashtrimet, trafikimet, prodhimet dhe shitjet e narkotikëve, veprimtaritë terroriste dhe që e gjithë kjo veprimtari e paligjshme është e provuar dhe e ndëshkuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Projektligji detyron subjektet, investitorët dhe operatorët që gjatë aplikimit të paraqesin vërtetimin nga dosja gjyqësore, që certifikon kushtet e përshkruara në pikën 2 të këtij ligji. Ky projektligj është një sinjal i fortë dhe i qartë për të gjithë atë kategori zaptuesish, përfituesish dhe klientësh që kanë përfutur nga moszbatimi i ligjit dhe kanë ditur të materializojnë paranë e pistë në të gjithë forcën e parasë dhe në të ashtuquajturin statusin e “të fortëve”.

Edhe në komplekset dhe njësitë e sotme akomoduese ka plot shembuj që vijnë nga e kaluara e afërt e investimeve që, edhe pse kanë emër të bukur, thirren me toponimet e poseduesve që kanë vepra penale. Prezenca e tyre në territorin publik turistik, përveç të tjerash, është edhe tregues pasigurie.

Ndaj unë e përshëndes këtë ndryshim ligji dhe do të isha edhe më i ashpër që ky ligj t’i shtrijë efektet jo vetëm për aplikuesit që investojnë në ndërtim, por edhe ndaj atyre që kanë përfutur prona dhe pasuri në mënyrë të paligjshme në zonat turistike të vendit.

Faleminderit!

(Drejtimin e seancës e merr zonja Hysi.)

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Nasufi!

Fjalën e ka kërkuar ministria Nikolla.

Lindita Nikolla – “Lindita Nikolla”, “Lindita Nikolla”, pesha e thirrjeve në 8 ditë shqetësimesh dhe përjetimesh të protestës studentore, është një peshë thirrjesh që nuk janë vetëm për mua, por për të gjithë ministrat e Arsimit, qeverinë dhe shoqërinë shqiptare.

Më takoi t’i përjetoja dhe peshoja me tërë fuqinë e mendjes dhe zemrës, si thirrje legjitime të një brezi që, në fakt, prezanton breza të tërë, të cilëve u është cenuar e ardhmja dhe u është vrarë merita.

Në këta 5 vjet mbyllëm 22 universitete dhe hoqëm nga tregu dhjetëra e mijëra diploma pa vlerë, dhjetëra e mijëra konkurentë të pandershëm, miliona euro të shkuara dëm nga xhepat e shqiptarëve, reformuam mësuesinë dhe nxitëm formimin e lartë profesional. Koha do të flasë.

Standardizuar sistemin e ri të pranimeve në universitet me busull të vetme meritën, në kushtet e një transparence të plotë.

Akredituam ndërkombëtarisht, për herë të parë, të gjitha institucionet e arsimit të lartë në vend dhe koha do të flasë.

Studentët kanë të drejtë! Ata kanë ngritur shumë çështje. A është problemi i arsimit tonë të lartë çmimi i dijes apo vetë cilësia me të cilën jepet dija? A janë sot e gjithë ditën të nevojshme ndryshimet e mëdha në mënyrën sesi përgatiten studentët tanë dhe sesi qeverisen universitetet? Për këtë nuk ka nevojë të flasë koha, por bërtas edhe unë me një "PO" të madhe dhe të fortë. Ligji i ri ka krijuar kushtet për një erë të re në arsimin tonë të lartë, por ai duhet zbatuar dhe, sigurisht, kërkon kohën e tij për të dhënë fryte dhe mentalitet të ri.

Sot me studentët në protestë, gjithkush ka të drejtë të më tregojë me gishtin. Askush nuk do të dëshironte të ishte në vendin tim. "Lindita Nikolla, dil nga ministria, të kanë ardhur studentët dhe jo ushtria!" – thërritën studentët. Unë dola dhe do të dal nga ministria, sepse nuk e kam të vështirë. Kam punuar çdo ditë si të ishte dita e fundit si ministre, nën peshën e përgjegjësisë për të mos turpëruar asnjë mësues dhe mësuese, pjesë e të cilëve jam, por edhe për të mos turpëruar askënd që besoi tek unë.

Të nderuar kolegë dhe kolege,

Do të kishte qenë shumë më e thjeshtë të administronim gjithçka gjetëm me kurikulën, tekstet, punësimin dhe trajnimin e mësuesve, me universitete gjithfarëshe, madje të mbyllnim edhe sytë përpara studimeve *part-time* apo doktoraturave pa kërkim shkencor. Po, do të kishte qenë më e lehtë edhe për "ndrikull Nikollën", herë me diplomë "Kristali" e herë me mesatare hyrëse apo dalëse nga universiteti sipas qejfit. Lëre pastaj ç'do të kishte qenë për luksin e çantave! Do të kisha shpëtuar unë, e gjora, nëse do të kisha administruar atë çfarë gjetëm nga memet, etiketimet, nga fotot e montuara dhe gënjeshttrat deri në 32 vite e kusur përpara jetës sime. Por jo, jam krenare dhe e përgjegjshme për forcën politike që i përkas, zgjodha të jem në krye të një reforme sistemike në arsim, nga kopshti në universitet.

"Lindita Nikolla, dil në bulevard, shkolla është jona dhe jo arsim privat!" Po, të dashur studentë, shkolla është juaja, ndaj i akredituam

universitetet! Shkolla është juaja, ndaj i mbyllëm 22 kioska! Shkolla është juaja, ndaj vumë rregull dhe nuk lejuam të ishin vende ku parkohej papunësia rinore, ku shiteshin diploma pa asnjë vlerë! Po, po, unë dal në bulevard me peshën e përgjegjësisë shtetërore për dhimbjen që ndiej, për pafuqishmërinë për të rregulluar vetëm në 5 vjet degradimin deri në rrënjë të sistemit tonë të lartë arsimor.

Faleminderit, kolegë dhe kolege, për mbështetjen dhe kurajën që më keni dhënë këta 5 vjet pune, sfide, në reformën sistemike, e përsëris, "sistemike" në çdo centimetër të sistemit tonë arsimor, nga kopshti deri në universitet.

E vërteta dhe puna kanë qenë aleati më i mirë për t'iu kundërvënë edhe turravrapit në një listë gënjeshtare dhe shpifarake, por koha do të flasë. Ajo që dua t'u them sot studentëve është se ata kanë të drejtë, por ftesa për të zhvilluar një betejë edhe më të vështirë është drejt tyre sot, ajo që tejkalon veten, duke parë vetëm të vërtetën në sy përmes një dialogu për të transformuar cilësisht universitet tona.

Jam e gatshme për të marrë çdo përgjegjësi!

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Ministre!

Këtu mbyllet edhe lista e diskutantëve të regjistruar më parë.

Kalojmë në diskutimin në emër të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste do të shprehet deputetja Eglantina Gjermani.

Eglantina Gjermani – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji që diskutojmë dhe do të miratojmë sot "Për disa shtesa në ligjin 93/2015 "Për turizmin", të ndryshuar", është propozuar nga Këshilli i Ministrave në kuadrin e një pakete ndërhyrjesh në 4 ligje me qëllim luftën ndaj kriminalitetit.

Konkretisht, ndryshime do të bëhen në këto 4 ligje: "Për prokurimin publik", "Për ndihmën shtetërore", "Për investimet strategjike" dhe "Për turizmin", të cilin po e diskutojmë sot.

Me qëllim luftën ndaj kriminalitetit dhe terrorizmit, ndryshimet ligjore po realizohen jo vetëm te ky ligj i prokurimit publik, por edhe në 3 ligjet e tjera duke synuar shmangien e çdo

mundësie që këto subjekte, kategori, të përmendura në projektligj të fitojnë kontrata apo marrëveshje publike.

Ndryshimet e propozuara në ligjin e turizmit synojnë: “Përjashtimin nga përfitimi i mbështetjes dhe lehtësive të parashikuara nga ky ligj, të personave të dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e disa veprave penale ku ata janë investitorë, operatorë, menaxhues, anëtarë të një organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës apo të kenë kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda investitorit apo operatorit menaxhues. Është shumë e rëndësishme të theksojmë se ndryshimet e propozuara vijnë në kuadër të përpjekjeve për të luftuar kriminalitetin dhe terrorizmin. Bërja e këtyre ndryshimeve në ligjin e turizmit do të shërbejë për të shmangur dhënien e kontratave, marrëveshjeve publike, fondeve publike, si dhe të mirave publike në përgjithësi investitorëve dhe operatorëve menaxhues të dënuar penalisht.

Këto ndryshime ligjore janë në harmonizim dhe në përfaqësim të plotë me direktivën e BE-së. Duke marrë këto masa ne mundësojmë parandalimin në kohë të përfshirjes në tendera publike të individëve me begraund kriminal dhe influencimin e tyre në përzgjedhjen e fituesve të këtyre tenderave me investime strategjike në një nga sektorët më të rëndësishëm, ku edhe vlerat e financimeve janë të larta. Për rëndësinë që kanë këto ndryshime ligjore kërkoj mbështetjen dhe votën tuaj për miratimin e projektligjit të turizmit.

Tani dua të them dy fjalë lidhur me protestën e studentëve. Në fakt, mbështetjen dhe reflektimin më të mirë e bënë kolegët, e bëri Kryeministri, sapa e bëri edhe kolegja, mikesha ime, ministrja e Arsimit, ku shprehën të gjithë gatishmërinë, të gjithë angazhimin dhe të gjithë reflektimin për t’iu përgjigjur, për t’u ulur në tryezë dhe për t’i zgjidhur të gjitha kërkesat e studentëve. Sigurisht, këtu nuk po flas vetëm si deputete, por edhe si pedagoge. Pa dyshim, ky reflektim vjen edhe si rezultat i mësimave që na dhanë studentët me protestën e tyre.

Ne themi shpesh se studentët janë ardhmja dhe duhet të investojmë tek ata, sepse janë ata që do ta bëjnë Shqipërinë më të mirë, por jo gjithmonë ia dalim të bëjmë më të mirën, me gjithë dëshirën dhe angazhimin tonë maksimal.

Ne të gjithë kemi nevojë dhe jo vetëm ne, jo vetëm politikbërja, por, pa dyshim, edhe pedagogët, universitetet, senatet, trupa akademike në përgjithësi t’i dëgjojmë më shumë, t’i përfshijmë më shumë, t’i angazhojmë më shumë, duke bërë më të mirën bashkë me ta.

Besoj se një nga mësimet e protestës së studentëve është që kërkesat dhe problemet që shtrohen janë të drejta, janë legjitime dhe kërkojnë angazhim maksimal nga të gjithë aktorët për t’i zgjidhur. Ndryshimi, në fakt, fillon me dialogun, duke kërkuar zgjidhjen e problemeve nëpërmjet një komunikimi të hapur dhe të drejtpërdrejtë, duke kërkuar më të mirën për studentët, për të ardhmen.

Zëri dhe kërkesat tuaja, të dashur studentë, janë dëgjuar dhe po dëgjohen nga qeveria. Sot ju morët një konfirmim tjetër nga ministrja e Arsimit dhe nga Kryeministri, angazhimin maksimal për t’i zgjidhur ato së bashku nëpërmjet dialogut, por duhet një urë komunikimi, duhet dialog. Mendoj se protesta duhet parë jo si një pengesë, por si një mundësi për të gjetur zgjidhje dhe kjo arrihet vetëm duke dialoguar dhe duke dëgjuar njëri-tjetrin.

Të dashur studentë, duke u ulur në tryezën e diskutimit për të ngritur shqetësimet edhe kërkesat tuaja legjitime, ju, në fakt, e mbron kauzën tuaj! Ju përfaqësoni nevojat dhe interesat e të gjithë studentëve shqiptarë, si dhe krijoni hapësirat e nevojshme që, së bashku me ju, të arrijmë t’i plotësojmë këto kërkesa. Kjo është një mundësi që të punojmë fort për ta përmirësuar arsimin e lartë, duke nisur një fazë të re transformimi për universitetet.

Nelson Mandela ka thënë: “Arsimi është arma më e fuqishme që mund të përdorësh për të ndryshuar botën, për të zhvilluar shoqërinë, për të rritur breza të rinj dhe gjenerata të suksesshme”. Pra, është momenti për të punuar bashkë, që ky ndryshim të ndodhë. Gjithçka që na duhet tani është të ulemi dhe të bisedojmë për zgjidhjen se si mund të plotësohen kërkesat tuaja. Për studentët absolutisht të gjithë duam më të mirën.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Gjermani!

Këtu mbyllet diskutimi në parim për projektligjin “Për disa shtesa në ligjin nr.93/2015 “Për turizmin”, të ndryshuar”.

Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës, te projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr.55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”. Kjo është nismë e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.

Fjalën e ka kërkuar ministri Ahmetaj.

Arben Ahmetaj - Momenti që po kalojmë, duke iu referuar edhe asaj që tha Kryeministri, është një moment reflektimi për mënyrën e qasjes që qeveria ka ndaj çdo problemi normal që kjo shoqëri kalon.

Në këndvështrim tim personal, në retrospektivë edhe të krahasimit jo me vend të dhjetorëve, dhjetori i vitit 1990, ishte një dhjetor i madh, që u pronësua nga studentët e asaj kohe dhe ndryshoi regjimet, duke shtyrë poshtë, në greminë një regjim, që ishte kalbur dhe inicioi një proces të gjatë, fatkeqësisht shumë të gjatë, tranzicionin. Ndërsa, protesta e studentëve është natyrale, me kërkesa racionale, të pastra, në themel të përmirësimit të jetës së tyre si studentë dhe të dinjitetit të tyre si studentë.

Duke i dëgjuar çdo ditë në ato që thonë, qoftë në ekrane, qoftë në protesta, reflektimi i parë është se këta janë një brez, që nuk po kërkojnë vetëm për veten e tyre, që po kërkojnë edhe për brezat e studentëve që do të vijnë më pas. Pra, ashtu siç u investua në 1990-ën për të ardhmen, ashtu po investohet sot edhe prej këtij grupi shumë të pastër studentësh me kërkesat e tyre dhe ky është një moment reflektimi shumë i rëndësishëm.

Mora shkas të flas nga ligji i investimeve strategjike për të bërë edhe një kujtesë me të gjithë ne, por edhe me të gjithë qytetarët që na dëgjojnë. Pavarësisht vështirësive që kalon Shqipëria, pavarësisht kësaj proteste, e cila është normale dhe natyrale, do të duhet të kujtojmë që këto fenomene ndodhin në të gjitha vendet demokratike. Ka një diferencë shumë të madhe nga çdo protestë që po ndodh sot në Europën demokratike: është një protestë e qetë, është një protestë me asnjë element dhune, është një protestë larg partive, është një protestë politike, patjetër, sepse kërkon përmirësimin e kushteve të jetesës dhe të arsimit, si dhe është një moment reflektimi për këtë qeveri, për këtë maxhorancë, por edhe për shoqërinë patjetër.

Për një sekondë të ndalojmë dhe të kthejmë sytë nga protesta për ta analizuar. Nuk po flas në thellësi, nuk po them që do të analizojmë

protestën këtu, tani dhe me çdo detaj, por një element do ta theksojmë: kjo është një protestë, një thirrje shumë e natyrshme dhe, po ta krahasosh me çdo lëvizje që ndodh sot në Europë, është shumë e maturuar, është shumë larg dhunës, është shumë brenda realitetit, është shumë e pastër, është shumë natyrale dhe, patjetër, meriton vëmendje, meriton respekt, meriton reflektim dhe meriton plotësimin e kërkesave nëpërmjet një dialogu. Dialogu, unë do të them sërish atë që tha Kryeministri, sjell në tryezë një proces shumë të gjatë reformimi brenda sistemit arsimor, sidomos arsimit të lartë.

A ka vlerë të përmendim sa janë harxhuar dhe sa harxhohen për arsimin e lartë? Unë besoj se, në nxehtësinë dhe emocionin e sotëm, askush nuk do t'i dëgjonte shifrat. Askush! Çdokush do të thoshte mjaft me shifra se na lodhe. Madje edhe Kryeministri im, kur unë përmend shifra sot, të krahasueshme, nuk i pëlqen, sepse mendon, beson dhe është duke bërë thellësisht atë që duhet bërë. Ka shumë punë për të bërë, jemi shumë larg pritshmërisë dhe gara me pritshmërinë është shumë e vështirë.

Megjithatë, ligji i investimeve strategjike më dha shkas të flas dhe të përmend sot, kur kemi një protestë studentësh (ne jemi aleatët e tyre të parë, ndoshta dhe të vetëm), se të gjithë kërkojnë ta shfrytëzojnë protestën e studentëve, të gjithë kërkojnë të nxjerrin gështenjat nga zjarri me duart e studentëve, që, në fakt, djeg Shqipërinë dhe nuk sjell asnjë përfitim, aq më tepër për studentët, ndërsa kjo maxhorancë, kjo qeveri nuk do as të shfrytëzojë, as të fikë dhe as të ndezë, por është fokusuar te një dialog për të zgjidhur problemet.

U bënë tri ditë që Shqipëria ka lajme të mira në aspektin ekonomik, por në emocionin e protestës, që unë e konsideroj realisht normale, është në momentin e duhur, në mënyrën e duhur për të shkundur çdo lloj maxhorance apo establishmenti politik që të mendojë ndryshe për të ardhmen e vendit, lajmet e mira kanë mbetur në hije. Unë do t'i them lajmet e mira jo për t'u treguar shqiptarëve se çfarë po bën kjo maxhorancë, por për të sjellë edhe një sens retrospektive dhe perspektive. Unë dua të them edhe një element tjetër, ndaj po i sjell shifrat.

Imagjinoni që e gjithë Shqipëria, socialistët në të gjithë Shqipërinë duke na përfshirë edhe ne të gjithëve, e mbështesim kauzën e studentëve,

theksojmë dhe mbështesim dialogun e studentëve. Kam një pyetje shumë naive: si ka mundësi që protesta, si ka mundësi që studentët, si ka mundësi që gjithë ajo materie fantastike brenda asaj proteste, mban larg gjithë politikën?! Si ka mundësi?! Opozita, e cila kërkon ta shfrytëzojë, ka mbetur jashtë realitetit, sepse kërkon ta shfrytëzojë vetëm për një qëllim protestën: t'i vërë zjarrin Shqipërisë, që të vijë, si zakonisht, ndër vite e vite, në hi në pushtet.

Pse nuk e ndjekin qytetarët? Për dy arsye themelore:

E para, sepse këta nuk i përfaqësojnë në hallin e tyre të vërtetë, në sinqeritetin e tyre të vërtetë.

E dyta, sigurisht, me hallet e mëdha që ka Shqipëria ka një trajektore, e cila ka lënë mbrapa vitin 2012 dhe vitin 2013.

Kushdo mund të më kthehet mbrapsht, madje edhe Kryeministri im, i cili mund të thotë se nuk kanë vlerë këto shifra që po them. Jo, unë i sjell shifrat për të treguar se sa larg është kjo opozitë nga studentët, nga shqiptarët, nga bujqit, nga fermerët, nga punëtorët.

Çfarë doli këto katër ditë? Doli shifra e investimeve të huaja. Shifra e investimeve të huaja është sërish një shifër rekord, larg asaj që ne duam, por edhe larg asaj që dëshirojnë këta, është 9% më e lartë. Dikush mund të më thotë se çfarë është 9% më e lartë?! Çfarë përqindje po na thua?! Jo! Unë jam duke thënë se ky është një moment shumë i rëndësishëm në jetën ekonomike të çdo shqiptari. Shqipëria e ka marrë kthesën, me vështirësi, duke lënë mbrapa atë kauzë, që këta e kanë ngritur si ideologji.

E dyta, doli papunësia dhe punësimi. Ka rënë papunësia në 12,2%. Sërish Kryeministri im do të më thotë: çfarë i ke këto shifra, sepse ka shqiptarë të papunë atje, të cilëve duhet t'u gjejmë punë dhe ta ndihmojmë ekonominë çdo ditë që t'i punësojmë? Po, por është e rëndësishme ta vendosim edhe në retrospektivë, edhe në prespektivë. Ishte 17,6%, ndërsa sot janë gati 240 mijë shqiptarë të punësuar, por janë ende dhe 200 mijë të tjerë, të cilëve duhet t'u gjejmë punë, ndër ta janë edhe këta studentë, që shumë shpejt do të dalin në tregun e punës.

E treta, është bërë një krahasim nga një institucion prestigjioz ndërkombëtar, që është koeficienti i ngushtimit të varfërisë. Sërish, Kryeministri im do të më thotë se çfarë është kjo

shifër, në Shqipëri ka shumë të varfër për të cilët do të duhet të punojmë çdo ditë nga 24 orë. Por unë e sjell për retrospektivë dhe për perspektivë, sepse ka qenë 0.3%. Po u shpjegoj qytetarëve, sepse ka një instrument që mat varfërinë në vend, atë reale dhe jo atë virtuale, i cili tregon se nga viti 2008 deri më sot është ulur. Në 5 vjetët e fundit është ulur me mbi 10 pikë. Dikush mund të thotë: përse i përmend pikët, sepse Dibra e ka shumë të lartë? Po, është e vërtetë që e ka të lartë, prandaj duhet të fokusohemi te Dibra. Atëherë, ju opozitës, kur dilni kundër Rugës së Arbrit, mendojeni mirë, sepse jeni duke punuar për t'i bërë ata njerëz më të varfër kur refuzoni dhe dilni këtu e flisni për partneritetin publik privat. Po, edhe Kukësi e ka ende të lartë varfërinë dhe patjetër që diferenca mes fshatit dhe qytetit është shumë e madhe, por viti 2012, si gropa më e thellë e varfërisë në këtë vend, është lënë mbrapa. Thënë këto, ky është një moment reflektimi për çdo gjë.

Dua t'u sjell qytetarëve dy shembuj nga protestat, edhe tre po deshët. Do t'ju sjell 21 janarin, që ta kujtojnë qytetarët dhe të bëjnë dallimin mes këtij Kryeministri e kësaj maxhorance dhe atij ish-Kryeministri e atyre që mungojnë këtu sot, të cilët kanë qenë në të njëjtën tryezë atë ditë. Atje protestuan qindra e mijëra shqiptarë dhe katër nga ata nuk u kthyen dot në shtëpitë e tyre. Ditën e pasnesërme në këtë parlament ish-Kryeministri ka thënë: "Ejani përsëri po deshët, se përsëri do t'ju vras, sepse këtu ka Kushtetutë". Shikoni rekordet!

Ky Kryeministër po u lutet studentëve që të vijnë të flasin sy më sy, të dialogojnë, me pika dhe me kërkesa tashmë të garantuara për zgjidhje, por jo thjesht me një letër për të thënë po, por për të hapur një proces, i cili garanton në themel demokracinë e Shqipërisë, dinjitetin e studentëve dhe jo vetëm të këtyre që kanë dalë sot në të drejtën e tyre, por edhe të atyre që do të vijnë si studentë më pas. Kjo është një nga herët e para kur një maxhorancë, në reflektim të thellë, krahason me vëmendje atë që kemi lënë mbrapa dhe atë që do të duhet të investojmë nëpërmjet këtyre studentëve në themel të së ardhmes.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Ministër!

Për këtë projektligj nuk ka të regjistruar në emër të grupeve parlamentare.

Më fal, zonja Gjylameti, por e ka kërkuar fjalën deputetja Hajdari për procedurë.

Rudina Hajdari – Sot kam ardhur për një arsye të vetme, jo për t'iu drejtuar këtij parlamenti dhe as për t'ju thënë se kam ardhur këtu për të marrë një llokmë të studentëve, pra për të marrë mbështetjen e studentëve, unë i dua ata studentë dhe bravo u qoftë, sepse po ndryshojnë historinë e këtij vendi, por unë kam ardhur këtu t'ju them edhe juve që rrini nëpër kafe e që asnjë nuk është në këtë seancë, se kushdo që foli këtu është kryehajdut dhe asnjëri nga ju nuk e do këtë vend dhe nuk ka për ta dashur. Nëse doni ndryshime për këtë vend, sillni Kodin Zgjedhor ta votojmë dhe mos i mbani listat e mbyllura. Vetëm atëherë do ta pastrojmë këtë parlament dhe këtë klasë politike, në këtë mënyrë do ta ndryshojmë këtë vend. A doni ndryshim për studentët? Ndryshoni auditorët dhe kapni pedagogët e korruptuar! Ky është ndryshimi. Nëse e doni këtë vend, mendoni seriozisht për të dhe mos ejani këtu për të bërë show politik, sepse jemi të ngopur. Ky vend është i ngopur. Këta studentë që dalin aty jashtë, nuk dalin vetëm se duan ndryshime, por sepse ata janë të lodhur nga çdo politikan, nga ju dhe nga këta, pra, nga çdo lloj politikani. Ata kanë humbur besimin e çdo njeri prej jush.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Hajdari!

Kalojmë në diskutimet në emër të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, do të shprehet deputetja Blerina Gjylameti.

Blerina Gjylameti – E nderuara drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në radhë të parë, dua të përmend faktin se ne si Parti Socialiste prej kohësh kemi qenë pro reformës zgjedhore dhe të gjithë anëtarët e Komisionit të Reformës Zgjedhore së bashku me ekspertët, të cilët janë dy nga figurat e Partisë Demokratike, kanë hartuar një draft, që është në parlament. Ekzaktësisht i bashkohem thirrjes së koleges Hajdari, që duhet të ketë më shumë kërkesë ndaj grupit të saj parlamentar për të ardhur dhe për ta votuar atë draft, sepse reflekton të gjitha rekomandimet e OSBE-ODIHR-it, në të tria raportet që ka dorëzuar për të tria zgjedhjet. Prandaj edhe një herë, i bashkohem thirrjes së

saj që duhet të vijmë këtu dhe ta votojmë, si një nga ligjet që ata e kërkuan me këmbëngulje të madhe dhe që është kusht për hapjen e negociatave. Tashmë është ashtu siç ata kanë kërkuar, kërkesat e tyre janë reflektuara, ndaj mjafton që të vijmë ta votojmë atë.

Për sa i përket pjesës së diskutimeve për projektligjet që kemi sot, janë dy çështje shumë të rëndësishme, të dyja projektligjet janë pjesë e një pakete dhe kanë impakt të drejtpërdrejtë jo vetëm në ekonominë vendase, por njëkohësisht edhe në jetën shoqërore.

Një nga vendimet më të rëndësishme të kësaj maxhorance ka qenë lufta pa kompromis ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit. Ndaj, pas më shumë se njëzet e ca vjetësh ishte pikërisht kjo maxhorancë që ndërmori hapin e parë e të pandalshëm të reformës në drejtësi; një nga reformat më të rëndësishme të ndërmarra në vendin tonë në këto vite, efektet e të cilës po ndihen edhe tani, duke vendosur themele të sigurta për prosperitetin e shoqërisë sonë të së nesërme.

Edhe nisma për investimet strategjike, që ne po shqyrtojmë sot, është e lidhur drejtpërdrejt me vullnetin që ne kemi treguar si maxhorancë për të ndarë njëherë e mirë shtetin ligjor nga krimi. Në kuadër të luftës pa kompromis ndaj krimit të organizuar, ky projektligj është hartuar me qëllimin e vetëm të mospërfitimit të mbështetjes dhe lehtësirave të parashikuara nga ligji jo vetëm nga investitorët, të cilët janë të dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale, por edhe nga personi i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë kur ai është anëtar i një organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës, apo ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda investimit. Kjo nismë e paraqitur në seancën e sotme nga Këshilli i Ministrave është një domosdoshmëri për trajtimin e fenomeneve shumë problematike të hasura në praktikë.

Në fakt, ky ligj nuk është i vetëm, por vjen bashkë me një sërë amendimesh në ligje të tjera, sikundër është ai për ndihmën shtetërore, prokurimin publik dhe ligjin për turizmin. Qëllimi i këtyre ndryshimeve ka të bëjë me ndalimin e përfitimit të të mirave publike nga subjektet e dënuara për një sërë veprash të rënda penale, që lidhen me krimin e organizuar, trafikimin, terrorizmin dhe korrupsionin.

Falë kësaj pakete dhe me hyrjen në fuqi të ndryshimeve, do të ndalohet çdolloj mundësie që kjo kategori subjektësh, shoqëri tregtare, aksionerë apo përfaqësues të tyre, të përfitojë nga taksapaguesit shqiptarë apo të përfitojë mbështetje financiare nga fondet publike për ushtrimin e aktivitetit të tyre fitimprurës.

Lufta ndaj krimit të organizuar nuk është e lehtë për asnjë vend dhe shoqëri kudo në botë. Gjithmonë grupet kriminale kanë fuqi ekonomike, por edhe instrumente moderne për të tentuar të kapin shtetin.

Sigurisht, ne si maxhorancë jemi të vetëdijshëm që mund të ishte bërë akoma më shumë në këtë drejtim, por të gjithë duhet të biem dakord që askush nuk mund t'i bëjë dot sot karshillëk forcës së ligjit. Ka qenë kjo maxhorancë që ka vendosur para drejtësisë emra, të cilët deri dje konsideroheshin të paprekshëm, kur edhe figura e punonjësit të policisë ishte autoritet më i ulët se njerëzit e krimit. Të gjithë jemi dëshmitarë që jo vetëm shumë prej tyre po shkojnë pas hekurave, duke marrë dënimin e merituar, por, mbi të gjitha, po shkëputen edhe lidhjet e botës së krimit me sistemin e drejtësisë dhe me botën e biznesit.

Në vetvete krimi i organizuar është një organizëm që bazat ekonomike të tij i ka tek ekonomia informale, tek evazionet fiskale, tek ata që pastrojnë paratë e trafikut të drogës dhe të qenieve njerëzore nëpërmjet bizneseve të licencuara në mënyrë ligjore. Paratë e klaneve të drogës dhe të trafikut njerëzor krijojnë të ardhura të mëdha dhe tërheqin kriminelët e organizuar t'i mbështesin ato.

Ndaj marrja e nismave të tilla, që dobësojnë botën e krimit, do të kontribuojë jo vetëm në luftën ndaj këtij fenomeni, por dhe në forcimin e shtetit dhe të ekonomisë vendase. Shqipëria ka nevojë për investitorë seriozë, ku investimet e tyre nuk janë flluska për të bërë pastrimin e parave, sikurse mendon bota e krimit. Ndaj edhe paketa e reformës në drejtësi pikërisht ka këtë synim, kthimin e besimit të qytetarëve te shteti ligjor dhe e bizneseve për të investuar në vendin tonë.

Është për të ardhur keq kur dëgjojmë kolegët tanë të opozitës të paragjykojnë, por edhe të godasin përditë me gurët e revanshit të dëshpëruar, që pasi kanë humbur çdo pushtet absolut mbi gjyqësorin e korruptuar deri në

palcë, kanë humbur edhe rrugën e arsyes. Jam shpresëplotë që procesi i vetingut po funksionon dhe pastrimi i shumëpritur prej dekadash i gjyqësorit po ecën me hapa të sigurt, duke ndezur një dritë shprese për këdo që deri dje e ka parë si një sistem të mbyllur dhe të korruptuar, ku në vend të drejtësisë pritej gjoba e padrejtësisë.

Vetingu po rikthen shpresën e qytetarëve se edhe në Shqipëri mund të ketë drejtësi ashtu siç duhet. Të gjithë ishim dëshmitarë kur kjo reformë hodhi hapat e saj të parë dhe shumë prej atyre që tashmë janë përjashtuar nga sistemi i drejtësisë për lidhje të fshehta me botën e krimit dhe, për fat të keq, akuza që i kemi dëgjuar edhe nga lidershpi i opozitës sonë, nuk lanë asnjë gur pa lëvizur duke kryer shantazhe të vazhdueshme, kërcënime të përditshme dhe bllokime si mundësi për të imponuar kthimin mbrapa. Por vetingu dhe i gjithë procesi i reformimit të drejtësisë nuk ndalet më.

Krijimi i KLGJ-së dhe KLP-së është hapi i parë dhe themelor për ngritjen e sistemit të ri, ku gjyqtarët e prokurorët me zotësi profesionale dhe integritet moral do të jenë kontribues të procesit. Këto dy organe të reja do t'i japin udhë procesit reformues të institucioneve, për t'u dhënë atyre pavarësinë, përgjegjshmërinë, funksionalitetin dhe eficiencën.

Kjo maxhorancë është e vendosur për ta çuar para këtë proces, por, sikundër e shikoni, opozita, në pamundësi për të gjetur një kauzë reale dhe për të pasur mbështetje popullore, po tenton të kapet herë pas protestës së banorëve të Astirit e herë pas protestës së studentëve. Kur flasim për protestën e banorëve të Astirit, ngrenë sot zërin ata që e lejuan atë paligjshmëri, që e nxitën atë paligjshmëri, që legalizuan biznese, por jo shtëpi dhe në fund të ditës flasin për padrejtësi. Ndryshe nga ta, pavarësisht çfarë ka ndodhur ndër vite dhe pavarësisht si e ka mbështetur ndër vite opozita paligjshmërinë, ne jemi për të dhënë zgjidhje dhe për t'i ndihmuar ata banorë.

E njëjta gjë edhe për studentët. Unë mendoj se PD-ja dhe LSI-ja duhet t'i mbajnë duart larg protestës, të mos infiltrojnë njerëz në protestë dhe të mos shantazhojnë studentët për të mos dialoguar.

Si pedagogë për shumë vite, apeli im për studentët është që të ulen për dialog, pasi

vlerësoj se është rruga më e mirë e mundshme drejt zgjidhjes së problemeve të tyre. Të gjithë e dimë që kërkesa e qeverisë për t'u ulur për dialog me studentët nuk është as presion dhe as karshillëk, por një dorë bashkëpunimi, ku palët të ulen për të gjetur zgjidhje për transformimin e të gjithë botës universitare.

Prej shumë vitesh arsimi i lartë në Shqipëri ka pasur shumë probleme dhe nuk është nevoja t'i përmendim këtu, por ama duhet të ulemi bashkë dhe të kemi një pakt bashkëpunimi mes studentëve dhe qeverisë.

I vlerësoj hapat e ndërmarrë nga qeveria për të pranuar diskutimin e tetë pikave që studentët kanë diskutuar. Por a mjaftojnë këto tetë pika? Si pedagogë u them që nuk mjaftojnë. Ka shumë më tepër probleme, që të gjithë i dimë, ndaj duhet që të gjithë të ulen dhe t'i diskutojnë me përfaqësuesit e qeverisë. Kjo kërkesë e sinqertë, drejtuar atyre, është pikërisht për të pasur një reformë edhe më të thellë, e cila i tejkalon ato tetë kërkesa.

Protestat paqësore, sidomos nga rinia, janë gjithmonë për t'u përshëndetur, sepse tregojnë forcën, energjinë dhe vitalitetin e një shoqërie. Protestat e tyre janë edhe një nga format më të mira për të arritur të tregojnë atë çfarë kërkojnë, që është shumë më tepër nga çfarë kanë marrë deri tani. E njëjta gjë është edhe nga ana e qeverisë: kërkon të bëjë shumë më tepër nga sa është bërë deri më tani. Ne që ndodhemi në këtë sallë, jemi prindër fëmijësh, që disa i kemi në shkollë, disa në universitete, ndaj të gjithë e dimë se ku duhet ndryshuar dhe duhet përmirësuar, por ama ky përmirësim vjen vetëm nëpërmjet bashkëbisedimit, nëpërmjet dialogut. Të gjithë e dimë se nëpërmjet infiltrimit, nëpërmjet përdorimit politik, nuk ka zgjidhje. Prandaj, do t'u bëj apel të gjithë studentëve, që të gjejnë një përfaqësi, të ulen në tavolinën e diskutimit, të ngrenë problematikat e tyre, madje të mos mjaftohen vetëm me ato, por të shkojnë edhe më tutje për të gjetur zgjidhje, e mbi të gjitha të arrijmë të kemi një vendimmarrje.

Kjo nuk bëhet në distancë, por bëhet si produkt i një pune të përbashkët e nëpërmjet dialogut.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Gjylameti!

Këtu mbyllet diskutimi në parim në lidhje me projektligjin “Për disa shtesa në ligjin nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”.

Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës, projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9643, datë 20. 11. 2006, “Për prokurimin publik” të ndryshuar.

Ka pyetje nga kolegët? Nuk ka.

Deputetë të regjistruar për diskutim nuk ka. Kalojmë në diskutimin në emër të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste do të shprehet deputeti Edmond Leka.

(Ndërhyrje nga salla)

Do të flisni? Më falni! Po, është regjistruar Taulanti, por është vënë tabela lart.

(Ndërhyrje nga salla)

Po. Dakord!

Vazhdoni!

Edmond Leka – E nderuara drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Me lajmin e mirë të dy ditëve të fundit, në lidhje me krijimin e dy organeve kryesore të vetingut, si dy shtylla të sistemit të pavarur gjyqësor: Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor, ne po shqyrtojmë sot disa projektligje shumë të rëndësishme, të cilat kanë të bëjnë me investime strategjike, me turizmin e me prokurimet publike.

Nevojat e mëdha të qytetarëve shqiptarë për krijimin e një sistemi të pavarur gjyqësor dhe me integritet të lartë, kërkojnë më shumë luftë e më shumë rezultate kundër krimit të organizuar dhe kundër korrupsionit.

Në kuadër të luftës pa kompromis kundër krimit të organizuar, ky projektligj “Për prokurimin publik” është hartuar me qëllimin e vetëm të mospërfitimit të fondeve publike, jo vetëm nga ana e operatorëve, të cilët dënohen me një vendim të formës së prerë në lidhje me kryerjen e veprave penale, por edhe në rastet kur personi i dënuar me vendim të formës së prerë është anëtar i një organi administrativ, drejtues, mbikëqyrës, ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse apo kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

Miratimi i tij vjen si një domosdoshmëri për trajtimin e fenomeneve shumë problematike, të hasura në praktikë. Në bazë të legjislacionit të

prokurimit publik në fuqi, çdo operator ekonomik, që synon të fitojë kontrata publike, rrjedhimisht edhe fonde publike, duhet të plotësojë paraprakisht disa kushte, të cilat ndahen në kushte ligjore, në kushte ekonomiko-financiare dhe në kushte teknike.

Nëse kushtet ekonomiko-financiare dhe kushtet teknike synojnë të sigurohen që subjekti fitues i kontratës publike është i aftë ta zbatojë atë, kushtet ligjore synojnë të sigurojnë që kontrata publike po lidhet një subjekt privat, i cili funksionon në përputhje me legjislacionin dhe rregullat e vendit, si dhe që ka integritet, profesionalizëm e përgjegjshmëri.

Duke pasur në konsideratë ndjeshmërinë e qeverisë shqiptare për të luftuar kriminalitetin në vend, duke shmangur në çdo rast e me çdo mjet dhënien e kontratave publike dhe fondeve publike operatorëve ekonomikë të dënuar penalisht, u mor në analizë parashikimi aktual në ligjin “Për prokurimin publik”, duke e vlerësuar në mënyrë krahasimore me parashikimin respektiv në direktivën përkatëse të Bashkimit Europian.

Nga analiza rezultoi se parashikimi ligjor aktual nuk ezauron edhe rastet kur një përfaqësues i operatorit ekonomik aksionar, ortak, administrator, përfaqësues ligjor e të tjerë, është i dënuar me vendim të formës së prerë. Po ashtu, në listën e veprave penale të parashikuara vlerësohet e nevojshme të shtohen edhe disa vepra të tjera.

Ky amendim vjen edhe më shumë në përputhje me nenin respektiv të direktivës përkatëse të Bashkimit Europian.

Një parashikim i tillë, më i zgjeruar e më gjithëpërfshirës, ku përjashtohet nga mundësia për të përfituar një kontratë publike jo vetëm në rastin kur operatori ekonomik që ka një dënim penal si subjekt juridik, por edhe kur individët përfaqësues të subjektit kanë një dënim të tillë, do të shmangë çdo mundësi që operatorët ekonomikë që kanë dënim penal si persona juridikë apo të përfaqësuar nga individë të dënuar penalisht, të mund të fitojnë kontrata publike.

Ky rregull i posaçëm do ta bëjë jo vetëm më serioze, por edhe më konkrete luftën me të gjitha mënyrat kundër krimit në Shqipëri.

Në përputhje me angazhimet e marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, Shqipëria

duhet të bëjë një përafrim të plotë me legjislacionin, dhe si i tillë, ky projektligj ka si qëllim përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Europian, duke realizuar kështu përmirësimin e kuadrit rregullator për prokurimet publike.

Projektligji është hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe nga Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë, në ministri, bashkërenduar me Ministrinë e Financave të Ekonomisë e me Ministrinë e Drejtësisë.

Miratimi i këtij projektligji nuk sjell efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit.

Së fundi, dy fjalë për protestën.

Duke e mbështetur plotësisht protestën e studentëve, të cilët prej disa ditësh kërkojnë plotësimin e disa kushteve pa dialog, unë mendoj se kjo gjë vetëm studentëve nuk u shërben. Shqipëria dhe shoqëria jonë kanë probleme shumë të mëdha e delikate, kanë kohë për çdo ndryshim dhe reformë të thellë. Nëse dëshirojmë kualitet, nuk mund të bëhet me një ditënatë. Le të dëgjohen të gjitha palët dhe të dialogojnë. Të gjitha palët duhet të jemi në gjendje t'i kapërcejmë dallimet, të gjejmë gjuhën e përbashkët, të ndërtojmë kuptimin dhe qëllimin, dhe po së bashku të vendosim drejtimit. Duhet të jemi në gjendje të mendojmë së bashku si ekupe, si komunitete dhe si qytetarë. Vetëm duke dialoguar do të jemi në gjendje të zbulojmë nevojat jetike.

Një dialog konstruktiv mund të sjellë përfitime të jashtëzakonshme. Mund të fitohen perspektiva të reja, të stimulohen nivele të reja të kreativitetit dhe të forcohet lidhja juaj, duke mos mundur t'ju përçajë askush. Kuptoni se çdo gjë arrihet vetëm me një punë dhe kufi afatgjatë, nëse prezumohet cilësi.

Së fundi, me qytetarinë që ju karakterizon, dialogoni!

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Leka!

Fjalën e ka deputeti Taulant Balla.

Taulant Balla – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Mendoj se edhe këto ndryshime që sjell sot qeveria në ligjin “Për prokurimin publik” janë ende larg një reforme edhe më të thellë që duhet të vijojmë, sigurisht një proces të vazhdueshëm konsultimi dhe asistence nga Komisioni Europian, që duhet ta bëjnë të qartë se duhet

ndërmarrë një reformë edhe më e thellë e prokurimeve publike, në bashkëpunim me qeverisë dhe Kuvendit. Kjo me qëllim që të rrisim sa më shumë transparencën në mënyrën, ecurinë dhe përfundimin e prokurimeve publike. Nisur edhe nga rasti më i fundit, referuar në prokurori nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, me ndihmën e medias, televizioni News 24 tregon se ende nuk kemi një filtër, i cili të mund të garantojë përzgjedhjen e ofertuesve më të mirë, që të sigurojë cilësi më të mirë të punimeve në rrugë.

Gjatë këtyre njëzet e tetë vjetëve ka raste pafund të lloj-lloj kompanive, të cilat me letra e pa letra, me falsifikime e pa falsifikime, depërtojnë në sistemin e prokurimit publik. Mbj mend 15-20 vjet më parë një kompani turke “Behase”, e cila e la për vite me radhë Peqinin dhe Rogozhinën pa rrugë, ndërsa më pas, një kompani italiane me emër të bukur, “Serenissima” mbajti peng për vite me radhë bajpasin e Fierit a të Vlorës, njërin prej tyre. Rasti më i fundit, referuar shumë mirë në prokurori nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe nga ministri Gjignuri, është një proces, i cili sigurisht, tashmë i përket drejtësisë, por ne si ligjvënës na takon që të rrisim sa më shumë filtrin, për të garantuar jo vetëm ofertuesin më të mirë, por edhe cilësinë më të mirë të punëve publike.

Kështu, meqenëse kjo çështje ka marrë edhe karakter politik, sepse këta, të cilët s’merren vesh kur vijnë e as nuk mbajnë mend kur ikin, e kanë kthyer këtë në çështje politike, dua të them se qasja jonë, edhe në rastin më të fundit, është një qasje tërësisht në mbështetje të hetimit, e një hetimi të thellë, që t’i shkojë problemit deri në rrënjë. Është i papranueshëm fakti që një kompani, e cila gjoja vjen nga Amerika, të depërtojë e madje të zgjidhet edhe fituese. Sigurisht, tashmë ministria dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar ia kanë referuar këtë prokurorisë, dhe unë jam shumë i sigurtë se prokuroria i ka në dispozicion të gjitha mjetet e provat për t’i shkruar kësaj historie deri në fund.

Së dyti, meqë fola për prokurorinë e për rastin e referuar, besoj se ky fundviti është një rast i mirë për të bërë një analizë të ecurisë së deritanishme të implementimit të reformës në drejtësi.

Si kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, por edhe si qytetar i thjeshtë i këtij vendi, ndjem krenar që tashmë tri institucionet bazë të drejtësisë janë zgjedhur dhe secili prej tyre është gati për të filluar mandatin. Brenda këtij viti, po të kemi parasysh afatet pesëditore dhe plus 3, pra tetëditore, që lihet si hapësirë edhe për ndonjë kontestim, brenda dhjetë ditëve të ardhshme do të kemi mundësinë që Këshilli i Lartë i Gjyqësorit dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë të jenë të konstituuar, duke i hapur kështu rrugë plotësimit të të gjitha vakancave të krijuara si në Gjykatën Kushtetuese, ashtu edhe në Gjykatën e Lartë, duke i hapur rrugë më pas procesit të zgjedhjes së Prokurorit të Përgjithshëm, a qoftë edhe konstituimit a ngritjes së Prokurorisë Speciale Antikorrupsion, që sigurisht, është një prej mekanizmave më të fortë të krijuar nga drejtësia e re, në luftën kundër korrupsionit.

E treta, por jo më pak e rëndësishme se çështja që trajtuam më lart, është ajo që u prek pak edhe nga deputetja më e re e Partisë Demokratike, zonja Hajdari, e cila i bëri thirrje maxhorancës për votimin sot të Kodit Zgjedhor. Në fakt, dëshira jonë është ta kishim votuar që sot, jemi gati, meqenëse edhe një përfaqësues i opozitës erdhi në sallë dhe tha: ejani të votojmë Kodin Zgjedhor!

Dua të sqaroj gjithë opinionin publik, se nga ana e Komisionit të Posaçëm të Reformës Zgjedhore, të drejtuar nga zoti Çuçi dhe zoti Bylykbashi është bërë një punë shumë e mirë. Drafti i Kodit Zgjedhor është përgatitur me asistencën e vyer të dy fondacioneve gjermane “Konrad Adenauer” dhe “Friedrich Ebert”, të cilat kanë përzgjedhur dy ekspertë shumë të njohur të kuadrit zgjedhor, sikurse janë zotërinjtë Ilir Rusmali dhe Viktor Gumi, të cilët, edhe me punën e të gjithë anëtarëve të komisionit, dhe gjej rastin t’i falënderoj, kanë bërë që, tashmë, të kemi një draft final, që është gati për t’u votuar dhe në themel ka të gjitha rekomandimet e OSBE-ODIHR-it për raportet e viteve 2013, 2015 dhe 2017.

Ajo që është më e rëndësishmja për t’u shpjeguar për të gjithë është fakti se në këtë draft të Kodit Zgjedhor më në fund partive u hiqet e drejta për të pasur komisionerë apo numërues. Historia që ne votohem dhe që i numërojmë vetë votat, me të cilat jemi votuar, duhet të marrë

fund njëherë e përgjithmonë me ndryshimet e Kodit Zgjedhor. Ne e kemi adresuar këtë rekomandim të OSBE-ODIHR-it, sepse është një rekomandim të cilit duhet t'i jepet zgjidhje domosdoshmërisht. Gjithashtu, ka edhe shumë çështje të tjera që kërkojnë zgjidhje. Një ndër to për ne, si Parti Socialiste, edhe pse në draftin aktual nuk gjendet i adresuar, është vota e shqiptarëve që jetojnë jashtë territorit, por ky është një proces më kompleks që kërkon edhe ndryshime kushtetuese. Por, përderisa zgjidhjet më të afërta janë ato vendoret, më 30 qershor të vitit 2019, dhe në shumë vende europiane për zgjedhjet vendore vota e atyre që jetojnë jashtë territorit nuk garantohet ende, ne duhet ta fillojmë punën më pas, në janar, shkurt, me një mandat tjetër të Komisionit të Reformës Zgjedhore, për të garantuar votën e shqiptarëve, të cilët jetojnë jashtë territorit.

Për seancën e javës së ardhshme, e cila rastis të jetë edhe seanca e fundit e sesionit të kësaj legjislature, apeli im për grupet parlamentare të PD-së dhe të LSI-së (të mos i mbetet hatri Fatmir Mediu, se ka marrë edhe disa deputet nga PD-ja dhe ka bërë Grupin Parlamentar Republikan) dhe PR-së është të vijmë në sallën e Kuvendit të Shqipërisë për të votuar paketën e reformës zgjedhore. Ky është një detyrim, por tregon edhe seriozitetin e këtyre grupeve për adresimin e rekomandimeve të OSBE-ODIHR-it.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Balla!

Këtu përfundon diskutimi në parim i projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar”.

Kalojmë në projektligjin tjetër, që është në rendin e ditës, “Për një shtesë në ligjin nr. 9374, datë 21.04.2005 “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar”.

Për këtë projektligj nuk ka diskutantë të regjistruar.

Në emër të Grupit Parlamentar të PS-së ishte regjistruar deputetja Blerina Gjylameti, e cila foli për të dyja projektligjet pak më parë.

Kalojmë në projektligjin tjetër “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i

ndryshuar”.

Për këtë projektligj nuk ka diskutantë të regjistruar.

Në emër të Grupit Parlamentar të PS-së do të shprehet deputetja Klotilda Bushka.

Klotilda Bushka – E nderuar zonja kryesuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Kam kënaqësinë që, në emër të grupit tonë parlamentar, të shpreh, tashmë, një hap tjetër drejt rrugës sonë në procesin e integritetit në Bashkimin Europian, i cili konkretizohet nëpërmjet ndryshimeve që bëhen në ligjin “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”. Ky ligj ndryshohet sot për të përmbushur një nga detyrimet kryesore që hyn në prioritetin e tretë, konkretisht “Lufta kundër korrupsionit”, pjesë e detyrimeve të parashikuara në udhërrëfyesin për pesë prioritetet kyçe për integritetin europian të vendit, nën dritën e rekomandimeve të shumta të instrumenteve dhe parterëve tanë ndërkombëtarë.

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive është një institucion tejet i rëndësishëm në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, abuzimit me detyrën dhe parandalimin e konfliktit të interesit. Roli i këtij institucioni është rritur edhe më shumë për shkak të përgjegjësisë që Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ka parashikuar në kuadër të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve, si dhe të përgjegjësisë të reja në kuadër të ligjit “Për sinjalizuesit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, ose siç e njohim në zhargonin publik ligji për bilbilfryrësit. Ky institucion, përveç rolit dhe imazhit pozitiv që ka jo vetëm në arenën vendase, por edhe atë ndërkombëtare për sa i takon luftës kundër korrupsionit, është një institucion që, tashmë, ka detyra të reja edhe më të plota, të cilat vijnë në të njëjtën linjë me frymën e reformës në drejtësi. Një nga këto kompetenca ka të bëjë edhe me kontrollin e deklarimeve, të cilat kryen *online*. Është gati sistemi *online* për deklarimin e pasurive, i realizuar së bashku me partnerët ndërkombëtarë, me USAID-in, Këshillin e Europës dhe Bashkimin Europian, në kuadër të programeve të përbashkëta të këtyre institucioneve. Ky sistem elektronik *online* publik është në përfundim dhe është gati për t'u pilotuar. Parashikimi në ligjin aktual është që ky sistem duhet të jetë gati jo më

vonë se tre vjet nga momenti kur është miratuar ndryshimi i ligjit aktual, pra në vitin 2017.

Por nevoja dhe detyrimi për të pasur një sistem *online* të deklarimit, i cili do të nxisë transparencën e të dhënave të zyrtarëve ndaj publikut, duke rritur edhe më tej luftën kundër korrupsionit, është tashmë një fakt që është adresuar dhe duhet të zgjidhet me mekanizma konkretë në ligjin tonë, sipas rekomandimeve që bën, në radhë të parë, progresraporti i Bashkimit Europian për Shqipërinë, i publikuar në prill të vitit 2018.

Në këtë raport, pasi jepen vlerësime për rolin e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit të Pasurive, rekomandohet gjithashtu që kapaciteti administrativ, teknik dhe financiar i këtij institucioni duhet të forcohet më tej, për të përballuar kontrollet e deklaratave të aseteve dhe pasurive të zyrtarëve.

Sistemi i deklarimit *online* të aseteve nuk është krijuar ende dhe rekomandohet të krijohet sa më parë të jetë e mundur.

Të njëjtat rekomandime i gjejmë edhe në raportin e GRECO-s, Grupi i Shteteve Kundër Korrupsionit, i cili në korrik të vitit 2018 ka nxjerr raportin e tij të dytë të përputhshmërisë në Shqipëri, i cili ka të bëjë me parandalimin e krimit për anëtarët e parlamentit, gjyqtarët dhe prokurorët.

Në raport GRECO shprehet: “Mbetet akoma punë për të bërë për krijimin e sistemit *online*, ku do të lejohet hedhja dhe menaxhimi elektronik i këtyre të dhënave”.

Rekomandimet e tjera të GRECO-s janë të gjitha të plotësuara. Ky ngelet një nga rekomandimet, që, në kuadër të integritetit në Bashkimin Europian, e nxit Shqipërinë të ecë përpara.

Edhe në strategjinë ndërsektoriale 2015-2020 kundër korrupsionit dhe në planin e saj të veprimit, në objektivin 5, parashikohet specifikisht që forcimi i regjimit të deklarimit dhe kontrollit të pasurisë të zyrtarëve publikë dhe rasteve të konfliktit të interesit, nëpërmjet mundësisit të deklaramëve *online* të pasurisë për të gjitha subjektet deklaruese, si dhe publikimi i tyre *online*, janë faktorë që kontribuojnë në kufizimin e korrupsionit.

Edhe në rezolutën që ka bërë Kuvendi i Republikës së Shqipërisë për veprimtarinë e institucionit të deklarimit të pasurisë për vitin

2017, është shprehur në mënyrë të posaçme angazhimi i Kuvendit dhe i qeverisë për të mbështetur institucionin e deklarimit të pasurive me financime të nevojshme për sigurimin e qëndrueshmërisë së sistemit elektronik të deklarimit të interesave private.

Këto janë detyrime, të cilat ne sot i përcjellim në ligj si mekanizma shtrëngues. Ky, në fakt, është pjesë e një vetingu të vërtetë të politikës dhe të zyrtarëve të lartë.

Forcimi i institucioneve, zbatimi i reformës në drejtësi, ngritja e gjykatës, prokurorisë dhe BKH-së (kur them prokurorisë dhe gjykatës, u referohem atyre speciale), si dhe forcimi i të gjitha institucioneve ligjzbatuese, që merren me kontrollin e pasurive, konfliktin e interesave dhe integritetin e zyrtarëve të lartë, janë premisa për luftën kundër korrupsionit edhe në radhët e zyrtarëve të lartë.

Ky është një veting i vërtetë dhe kjo tregon vullnetin e kësaj maxhorance për të çuar përpara reformën në drejtësi, për të çuar përpara luftën kundër korrupsionit, krimit të organizuar dhe lidhjes së politikës me të, thënë këto në projektligjin që po diskutojmë dhe do të miratojmë sot.

Përveç ngritjes dhe hapjes së rrugës të ndërtimit të sistemit *online* dhe vënies së tij në përdorim, kemi parashikuar qartësimin e detyrimit që subjektet aktuale, të cilat i kanë plotësuar tashmë deklaratat jo nëpërmjet sistemit *online*, të jenë të qarta dhe të sakta, sipas standardeve, që janë të pranura gjerësisht edhe nga konsulentët tanë ndërkombëtarë, EURALIUS dhe USAID; qartësimin e mënyrës së dorëzimit të deklaratave të interesave private, me ngritjen dhe vënien në funksionim të sistemit elektronik *online*; krijimin e mundësisë që inspektorët e autorizuar nga Inspektorati i Deklarimit të Pasurive, t’u adresojnë kërkesë bankave të nivelit të dytë dhe subjekteve të tjera, që ushtrojnë veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë, për të marrë të dhëna për depozitat, llogaritë dhe transaksionet e kryera nga personat që kanë detyrimin të deklarojnë pasuritë e tyre.

Janë hequr afatet që parashikonte ligji, duke shpejtuar zbatimin e procesit të regjistrimit të të dhënave, deklarimit, si dhe kontrollit, nëpërmjet një sistemi *online*.

Në këtë mënyrë, ne kemi hapur rrugën ligjore për plotësimin për herë të parë të deklaratës së interesave private nga subjektet që bartin detyrim për deklarim, nëpërmjet sistemit të deklarimit me anë të mjeteve elektronike.

Përveç kësaj, në ligj është bërë edhe një ndërhyrje në teknikën legislative. Janë shprehur garancitë për përputhshmërinë e të dhënave të deklaruara më parë, me ato të sistemit të ri elektronik, si dhe është parashikuar një mekanizëm zhbllokues për zgjedhjen e titullarit të institucionit, duke iu referuar frymës së reformës në drejtësi dhe mekanizmeve zhbllokues, të cilët nuk pengojnë ecurinë e zgjedhjes së titullarit të institucionit, për t'i dhënë mundësinë këtij institucioni të funksionojë normalisht.

Në përfundim, doja të falënderoja misionin EURALIUS, partnerët, USAID-in, Këshillin e Europës, të cilët na qëndruan pranë në këtë nismë, për ta përmirësuar dhe për ta sjellë atë në përputhje me të gjitha standardet ndërkombëtare!

Falënderoj të gjithë kolegët e Komisionit të Ligjeve, që ishin pro kësaj nisme, si dhe gjithë grupin e punës!

Edhe një herë shpreh besimin, siç po e tregojnë veprimet konkrete të kësaj maxhorance, ashtu siç po ndodh edhe me këtë projektligj, që për ne reforma në drejtësi nuk do të ndalet. Zbatimi i saj është tashmë në rrugë të drejtë.

Nuk na mbetet gjë tjetër veçse ta votojmë këtë projektligj dhe t'i urojmë punë të mbarë Inspektoratit të Deklarimit të Pasurive, për të intensifikuar luftën kundër korrupsionit dhe lidhjes së politikës me krimin e organizuar!

Ju faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Bushka!

Këtu mbyllet diskutimi në parim për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar”.

Të nderuar kolegë, bëjmë pesë minuta pushim, për të filluar më pas me votimin.

(Drejtimin e seancës e merr zoti Ruçi.)

Gramoz Ruçi – Rifillojmë seancën.

Hapet votimi për prezencën.

Mbyllet votimi.

73 deputetë prezentë.

Fillojmë me projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr.7764, datë 02.11.1993 “Për investimet e huaja”, të ndryshuar”. Ky projektligj kërkon shumicë të thjeshtë votash.

Hapet votimi në parim me elektronikë.

Mbyllet votimi.

72 vota pro. 1 kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet në parim.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2 “Hyrja në fuqi”. Komisioni propozon hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit.

Në mbështetje të nenit 84, pika 4, të Kushtetutës, në rastet e masave të jashtëzakonshme, si dhe në rast nevojë dhe urgjence, kur Kuvendi vendos me shumicën e të gjithë anëtarëve dhe Presidenti i Republikës jep pëlqimin, ligji hyn në fuqi menjëherë. Vetëm pasi të jetë njoftuar publikisht, ligji duhet të botohet në numrin më të parë të Fletores Zyrtare.

Lidhur me këtë ju njoftoj se Kuvendi me shkresën nr. 3870, datë 11.12.2018 i ka kërkuar Presidentit të Republikës hyrjen menjëherë në fuqi të ligjit, por deri tani nuk ka ende një përgjigje dhe për pasojë hedhim në votim me karton nenin 2, sipas variantit të propozuar “Ligji hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare”. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

72 vota pro. Asnjë kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet.

Kalojmë në projektligjin “Për disa shtesa në ligjin nr.93/2015 “Për turizmin”, të ndryshuar”. Ky projektligj kërkon shumicë të thjeshtë votash.

Hapet votimi në parim.

Mbyllet votimi.

72 vota pro. Asnjë kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen me kartonë, me vërejtjet e komisioneve që e kanë shqyrtuar këtë projektligj.

Neni 1, me vërejtjet e komisionit për riformulim neni. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

72 vota pro. Asnjë kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet.

Kalojmë te projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr.55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë””. Ky projektligj kërkon shumicë të thjeshtë votash.

Hapet votimi në parim me elektronikë.

Mbyllet votimi.

72 vota pro. Asnjë kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet.

Kalojmë në shqyrtimin nen për nen me kartonë, me vërejtjet e dy komisioneve, që e kanë shqyrtuar këtë projektligj.

Neni 1, me vërejtjet e të dyja komisioneve. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

72 vota pro. Asnjë kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet.

Vazhdojmë me projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar”. Ky projektligj kërkon shumicë të thjeshtë votash.

Hapet votimi në parim me elektronikë.

Mbyllet votimi.

72 vota pro. Asnjë kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet.

Kalojmë në shqyrtimin nen për nen me kartonë, me vërejtjet e komisionit përgjegjës.

Neni 1, me vërejtjet e komisionit përgjegjës për pikën 1, paragrafi i parë, si dhe riformulimin e germave “d” dhe “ë”. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Hapet votimi në tërësi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

72 vota pro. Asnjë kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet.

Vazhdojmë me projektligjin “Për një shtesë në ligjin nr.9374, datë 21.04.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar”. Ky projektligj kërkon shumicë të thjeshtë votash.

Hapet votimi në parim me elektronikë.

Mbyllet votimi.

72 vota pro. Asnjë kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet.

Kalojmë në shqyrtimin nen për nen me kartonë, me vërejtjet e të dyja komisioneve që kanë shqyrtuar projektligjin.

Neni 1, me vërejtjet e të dyja komisioneve për paragrafin e parë pikën 1, dhe riformulimin e germave “d” dhe “ë” të kësaj pike. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Hapet votimi në tërësi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

72 vota pro. Asnjë kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet.

Vazhdojmë me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar”. Ky projektligj kërkon shumicë të thjeshtë votash.

Hapet votimi në parim me elektronikë.

Mbyllet votimi.

72 vota pro. Asnjë kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet.

Kalojmë në shqyrtimin nen për nen me kartonë, sipas variantit integral të propozuar nga komisioni përgjegjës, të cilin e keni të gjithë përpara.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 3. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 4. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 5. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

(Nga neni 6 deri në nenin 15 ndiqet e njëjta procedurë votimi)

Kalojmë në votimin në tërësi me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

72 vota pro. Asnjë kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet.

Projektvendim “Për emërimin e një anëtari të Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë”. Ky projektvendim kërkon shumicë të thjeshtë votash. Ekipi përzgjedhës, në bazë të nenit 11, pika 4, të ligjit nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” ka propozuar për vendin vakant dy kandidatura, konkretisht, zotin Enton Shahaj dhe zonjën Rajmonda Islamaj. Procedura e votimit është dy votime të fshehta.

Hapet votimi me elektronikë për zotin Enton Shahaj.

Mbyllet votimi.

2 vota pro. 68 kundër. 2 abstenim.

Nuk fiton.

Hapet votimi me elektronikë për zonjën Rajmonda Islamaj.

Mbyllet votimi.

65 vota pro. 3 kundër. 4 abstenim.

Miratohet.

Zonja Rajmonda Islamaj emërohet në detyrën e anëtarit të Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë.

Projektvendim “Për shqyrtim me procedurë të përshpejtuar të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar”. Ky projektvendim kërkon shumicë të thjeshtë votash.

Në mbështetje të pikës 3 të nenit 28 të Rregullores, duhet të shprehet një folës pro dhe një kundër, nëse ka, jo më shumë se 10 minuta. Dëshiron të flasë njeri? Jo. Projektvendimi u është shpërndarë deputetëve. Komisioni përgjegjës është Komisioni për Sigurinë Kombëtare. Procedura e votimit është votim me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

72 vota pro. Asnjë kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet.

Nga seancat e kaluara, për mungesë kuorumi, kemi dy projektligje të mbartura: “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe “Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Këto ishin çështjet e parashikuara për seancën e sotme. Seancën e deklaroj të mbyllur! Për orën dhe ditën e seancës tjetër do të njoftoheni.

(Seanca u mbyll në orën 13:00)

Kryetari i Kuvendit

Gramoz Ruçi

Sekretari për Procedurat dhe Votimin

Alket Hyseni

**Drejtori i Shërbimit të Botimeve
Parlamentare
Krenar Hajdëri**